

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7791 E martë 12 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Intervista e Ditës

Nga BEKIM SHEHU



A ka gjasa për një marrëveshje Kosovë-Serbi?

Analisti i Grupit Ballkanik për Politikën e Zhvillimit, Naim Rashiti, në intervistë për "DW", flet sesi do të dukej një marrëveshje finale Kosovë-Serbi...
Vijon në faqen 20

Opinion i Ditës

Nga IZELA TAHSINI



Kultura e dhunës fshihet pas perdes së patriarkatit

Në ditët në vijim të ngjarjes së rëndë në Kavajë - ku një grup djemsh adoleshentë akuzohen për përdhunimin e një vajzë minorene, tronditja vihej ...
Vijon në faqen 21



Agron Shehaj: Po vazhdoni të vidhni

70 milionë euro për 16 km në Orikum-Dukat, debati PS-PD në Kuvend për koncesionet "PPP"

Komisioni miraton ndryshimet ligjore për veprat publike. Debatimi me zv.ministren e Financave

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese diskutoi edhe ndryshimin e projektligjit për koncesionet dhe PPP-të. Ministria e Financave propozoi që nga 1 korriku i këtij viti të mos jepet më asnjë projekt me PPP kur nuk ka një ofertë. Ndërkohë, deputetët e opozitës kanë qenë ata që kanë ngritur dyshime, ndërsa mes tyre deputeti Agron Shehaj ka ngritur ...
Në faqen 6

NDERTIMET INFORMALE/ PUBLIKOHET LISTA E FAMILJEVE QE MARRIN LEJET

LEGALIZIMET NE TIRANE, EMRAT E 250 PERFITUESVE

Procedura për certifikatën e pronësisë do të ndiqet nga ALUIZNI. Sipërfaqja e legalizuar nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i ndërtimit



(Në foto) Ndërtime informale në Tiranë

ISH-KRYEMINISTRI

Majko: Kosovë-Serbi, shkëmbimi i territoreve, ide e çuditshme

Në faqen 4

ADMINISTRATA

"Zëri i Amerikës": Shkarkimet e padrejta, vjet u paguan 100 mln euro dëmshpërbim

Në faqen 3

LISTA EMERORE

Rezultatet e provimit për 1 mijë infermierë në 10 qarqe të vendit

Në faqen 11-13

PARATE NGA BUXHETI

KQZ "zgjidh qesen", PS merr 86 milionë lekë, PD 52 milionë dhe LSI 27 milionë

Në faqen 2

SKENARI I DYSHIMTE



Hije skandali në koncesionin e laboratorëve spitalorë

Në faqen 9

Nëna e së miturës flet në media: Në komisariat s'ma pranuan denoncimin

I çonte video nudo 15-vjeçares, pranga policit

Opozita i kërkon dorëheqjen, Sandër Lleshaj: Policët arrestuan një pervers

SHKODËR-Pak ditë pas skandalit në Kavajë, ku një minorene u abuzua seksualisht përmes kërcënimit të publikimit të një videoje intime, një tjetër rast i rëndë shantazhi dhe abuzimi ndaj të miturve është denoncuar nga qarku i Shkodrës. Kësaj here autori është një efektiv



policie, i cili ka përfunduar në pranga pas zbulimit të një skandali seksual ndaj një vajze 15-vjeçare. Bëhet fjalë për shtetasin Berhan Bajrakurti, specialist i policimit në Komunitetin në Gruemirë, në Komunitetin e Policisë së Malesisë së Madhe ...

Në faqen 14

ZGJEDHJET FINANCIMI

Komisioni ka shpërndarë lekët që përfitojnë partitë nga Buxheti i Shtetit

KQZ "zgjidh qesen", sa lekë marrin PS, PD, LSI dhe partitë e vogla

PS ka marrë më shumë se PD dhe LSI bashkë

Gjashtë partitë kryesore politike në vend kanë ndarë mes tyre 1.9 miliardë lekë të vjetra nga fondit vjetor i përcaktuar nga Buxheti i Shtetit për partitë politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e djeshme ka miratuar vendimin me anë të të cilit bën shpërndarjen e lekëve që përfitojnë partitë politike, që në zgjedhjet e shkuara politike kanë marrë 10 mijë vota, si dhe kanë përfaqësuar në Kuvend. Nga përlllogaritja që KQZ i ka bërë zbatimit të formulës që përcakton ligji "Për partitë politike", Partia Socialiste ka marrë edhe pjesën e "luanit", duke përfituar plotësisht 860 milionë lekë, ndërkohë që PD ka përfituar 520 milionë lekë dhe LSI 270 milionë.

FORMULA

Ligji "Për partitë politike" përcakton rregullat sipas së cilave bëhet shpërndarja e fondeve vjetore për partitë politike. Sipas këtij ligji, 70 për qind ndahet sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Ndërkohë që 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë marrë mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 për qind dhe u ndahet partive parlamentare.

SHPËRNDARJA

Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare për vitin 2019 është shumatorja e të gjitha shumave që rezultojnë nga llogaritjet e mësipërme. Sipas këtyre përlllogaritjeve, rezultoni se partia që do të përfitojë më shumë është Partia Socialiste e Shqipërisë. Ajo ka siguruar 860 milionë lekë të vjetra,



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

FORMULA

70 për qind ndahet sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Ndërkohë që 20 për qind, në mënyrë të barabartë, ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë marrë mbi 10 mijë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe 10 për qind, sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi.

Vendimi, sa do t'u kushtojnë shqiptarëve zgjedhjet vendore

Gjatë mbledhjes së djeshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi edhe strukturën e shpenzimeve buxhetore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 qershor 2019. Në total KQZ-ja parashikon që të harxhojë rreth 1.2 mld lekë, çka në fakt do jetë edhe kostoja e asaj që do t'i kushtojë Buxhetit të Shtetit vetëm organizimi i zgjedhjeve lokale, pa përfshirë këtu lekët që përfitojnë vetë partitë politike. Sipas buxhetit të parashikuar të KQZ-së, do të shpenzohet një fond i konsiderueshëm për 400 trajnuesit e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe të Grupit të

KOSTOJA E ZGJEDHJEVE	
■ Shpërblimi i anëtarëve të komisioneve -	296,032,371 lekë.
■ Mallra	- 248,881, 320 lekë.
■ Shërbime	- 274, 968, 336 lekë.
■ Shërbime transporti	- 221,700,000 lekë.
■ Shërbime udhëtime e dieta	- 11,568,000 lekë.

Numërimit të Votave. Më konkretisht, parashikohen 296 milionë lekë për shpërblimin e anëtarëve të komisioneve, 248 milionë për zërin mallra, 274 milionë për zërin shërbime, 221 milionë për zërin shërbim transporti dhe 115 milionë për dieta e udhëtime. Në këto zgjedhje

parashikohen dy fletë votimi, një për kandidat për kryetar bashkie dhe tjetra për këshillin bashkiak. Për secilën fletë, KQZ-ja parashikon prodhimin e mbi 3.6 milionë fletëve të votimit, në total 7,235, 482 fletë votimi në një kosto rreth 90 milionë lekë.

cialiste për Integrim ka marrë 271 milionë lekë. Përveç 3 partive kryesore, nga zbatimi i kësaj formule që përcakton ligji kanë marrë lekë nga Buxheti i Shtetit për vitin 2019 edhe 3 parti të tjera, respektivisht

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet ka marrë 100 milionë lekë, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë 72 milionë lekë dhe Lista e Barabartë e Ben Blushit 65 milionë lekë, ndonëse nuk është parti par-



Presidenti i Republikës Ilir Meta, dje gjatë konferencës "Marrëdhëniet e punës dhe shqyrtimi gjyqësor"

SHUMA QË KA PËRFITUAR SECILA PARTI

- 1) Partia Socialiste e Shqipërisë - 86.065.992 lekë.
- 2) Partia Demokratike e Shqipërisë - 52.808.975 lekë.
- 3) Lëvizja Socialiste për Integrim - 27.160.224 lekë.
- 4) Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet - 10.107.290 lekë.
- 5) Partia Socialdemokrate e Shqipërisë - 7.286.685 lekë.
- 6) Lista e Barabartë - 6.570.833 lekë.

Maqedonia në NATO, Shqipëria miraton të enjten protokollin

Shqipëria do jetë një nga vendet e para që do të japë pëlqimin e saj për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Kjo, pasi Kuvendi i Shqipërisë pritet të votojë të enjten Protokollin e Anëtarësimit të Maqedonisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Protokollin në fjalë ka marrë dje votën për të Komisionit të Ligjeve, i cili ka hapur kështu dritën jeshile të votimit të tij në seancë. Me një konsensus të plotë, anëtarët e opozitës dhe të mazhorancës votuan pro protokollit, i cili i hap rrugë shtetit të Maqedonisë së Veriut për t'ju bashkuar kësaj aleancë si anëtarja e 30-të. Në seancën e së enjtes në Kuvend pritet të jetë i pranishëm edhe kreu i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi. Arritja e marrëveshjes mes Greqisë dhe Maqedonisë është konsideruar si një hap pozitiv, e cila i jep garancë e paqes dhe prosperitetit në Ballkan. Nga ana tjetër, të premtën e shkuar, parlamenti grek ratifikoi protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO duke i dhënë fund një klime të tensionuar, që ka mbajtur konfliktin e "ndezur" në këto dy vende për më shumë se dy dekada. Me hyrjen në fuqi të këtij protokollit, sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior i njofton Qeverinë e Maqedonisë së Veriut, në emër të të gjitha palëve, ftesën për t'u pranuar në Traktatin e Atlantikut Verior. Në përputhje me nenin 10 të Traktatit, Republika e Maqedonisë së Veriut bëhet palë në datën kur depoziton instrumentin e saj të aderimit të Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky protokoll hyn në fuqi kur secila nga palët e Traktatit të Atlantikut Verior ka njoftuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për pranimin e saj. Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës informon palët e Traktatit të Atlantikut Verior mbi datën e marrjes së këtij njoftimi, si dhe datën e hyrjes në fuqi të këtij protokollit.

lamentare. Krahasuar me një vit më parë, partitë politike kanë përfituar më shumë lekë, kjo pasi fondit i vënë në dispozicion nga qeveria për këtë vit është më i madh, nisur kjo ndoshta edhe nga fakti që ky

është një vit zgjedhor. Gjithsesi, përveç këtij fondi, për përballimin e fushatës zgjedhore KQZ do miratojë edhe një vendim tjetër me anë të të cilit do ndajë lekët për partitë pjesëmarrëse në zgjedhje.



Meta: Largimet e padrejta nga puna, fatura t'i kalojë zyrtarit që ka bërë shkarkimin

Studimi, 100 mln USD të humbura nga gjyqet në administratë

Gjyqet, sa duhet të paguajë shteti si dëmshpërblim

Qendra e Studimeve INFOCIP publikoi dje një studim mbi marrëdhëniet e punës, sipas të cilit, rreth 30% të ngarkesës në gjykatat administrative dhe 60% të çështjeve në Gjykatën e Lartë në tre vitet e fundit e zënë punësimet dhe shkarkimet nga puna. "Në 2018 Gjykata Administrative e Apelit dhe gjithsej 4743 vendime, prej të cilave 1400, ose 29.5%, kishin objekt marrëdhëniet e punës. Në 2017 dha 5546 vendime, prej të cilave 1601 ose 30%, kishin si objekt marrëdhëniet e punës. Afro 77% e ankimesve i kanë fituar çështjet e tyre gjyqësore për pushim të padrejtë nga puna" - thotë studimi i INFOCIP-it. Sipas raportimit të VOA, janë 10 mijë e 625 paga që shteti duhet të paguajë si dëmshpërblim për personat që fituan çështjet gjyqësore ndaj tij në 2018 në Apelin Administrativ. Janë 19003 paga, të cilat duhen paguar si dëmshpërblim personave që fituan gjyqet në 2017. Për rreth 30 mijë paga, të cilat duhen dëmshpërblim për dy vitet e fundit fatura që duhet paguar nga shteti është rreth 15 milionë euro. Në vitin 2015 nga thesari i shtetit u paguan rreth 22 milionë euro për ekzekutim vendimesh gjyqësore të viteve pararendës. Në 2018 u paguan nga thesari i shtetit rreth 100 milionë euro dëmshpërblime pagash për pushime të padrejta nga puna sipas rasteve të shpërndara në vite të ndryshme gjatë dekadës së fundit. Ndërkohë në Apelin Administrativ akoma nuk kanë mbërritur çështjet e vitit 2017, i cili ishte një vit zgjedhor.



Presidenti Ilir Meta

Meta: KLGJ e prokuroria të hetojnë vendimin për Dritan Dajtin

Presidenti Ilir Meta një soj si ambasadori i BE-së, Luigi Soreca kërkon angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorisë për të hetuar vendimin që anulon dënimin me burg për jetë të Dritan Dajtit. Z.Meta reagoi dje pas vendimit të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për Dritan Dajtin, i cili vrau 4 policë dhe u dënua me 25 vite burg si rezultat i gjykitimit të shkurtuar. Meta tha se mbështet thirrjen e ambasadorit të BE në Tiranë dhe se KLGJ dhe prokuroria duhet të vihen në lëvizje për të verifikuar dhe hetuar çështjen. "Mbështes fuqimisht reagimin dhe thirrjen e ambasadorit të Bashkimit Europian, zoti Soreca, që KLGJ-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme të vihen në



lëvizje për të vlerësuar dhe për të verifikuar dhe hetuar çështjen në fjalë" u shpreh Meta në një prononim për gazetarët pasi mori pjesë në konferencën e organizuar nga INFOCIP me temë "Marrëdhëniet e punës dhe shqyrtimi gjyqësor". Dy ditë më parë përmes një postimi në Twitter, ambasadori i BE, Soreca u shpreh se ky vendim duhet vlerësuar nga KLGJ

PËR ANJELIN
"Unë jam i bindur që të gjitha zgjidhjet dhe propozimet e Presidentit të Republikës synojnë forcimin e institucioneve të pavarura, dhe gjithmonë këtë gjë do të synojnë, synojnë forcimin e sundimit të ligjit në vend dhe jo të sundimit të shumicave", - tha z.Meta.

dhe Prokurori i Përgjithshëm. "Vendimi i Gjykatës së Apelit për zvogëlimin e dënimit të të pandehurit të dënuar për vrasjen e 4 policëve bën thirrje për vlerësim urgjent nga KLGJ dhe Prokurori i Përgjithshëm. Reforma në drejtësi është e paktëshme dhe do të mbulojë të gjitha nivelet e juridiksionit", - tha z.Soreca.

qenë nevoja që shteti të paguajë dy rroga për të njëjtin vend pune, e në ndonjë rast dhe tre paga. Nga studimi del se një punonjësi që humb punën në shtet pret në dyert e gjykatës mesatarisht 840 ditë (2.3 vjet) për të gjetur drejtësi në të dyja shkallët e gjykim-it. Shtuar edhe shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, pritja arrin mesatarisht 1730 ditë ose rreth 4.7 vjet.

PRESIDENTI
Presidenti i Republikës Ilir Meta gjatë fjalës së tij në konferencën e organizuar nga INFOCIP me temë "Marrëdhëniet e punës dhe shqyrtimi gjyqësor", deklaroi se duhet të plotësohet puna e nevojshme gjyqësore në Gjykatën Administrative për të mos pasur vonesa në vendime. Meta u shpreh se sa i përket largimeve të pa-

drejta nga puna në administratë, faturën duhet ta paguajë zyrtari publik që e ka shkarkuar punonjësin në mënyrë të padrejtë dhe jo taksapaguesi shqiptar. Kreu i shtetit deklaroi se rastet e largimit të padrejtë nga puna janë konkrete dhe se numri është në rritje. Meta u shpreh se ligjet e miratuara janë të mira, por nuk zbatohen, ndërsa kërkoi që të shrohet për diskutim ideja, që, nëse gjykata i jep të drejtë punonjësit të shkarkuar, atëherë të jetë zyrtari që e ka liruar nga detyra që të paguajë kostot financiare dhe jo taksapaguesit. "Numri në rritje i konflikteve gjyqësore dhe me një trupë gjyqësore ende të pafortuar sjell vonesa në vendime. Gjykata administrative duhet të plotësohet

me trupën e nevojshme. Është rritur numri i konflikteve në marrëdhëniet e punës dhe 30% e rasteve në Administrative janë për problemet në marrëdhëniet e punës. Duhet të përcaktohet me ligj evidencimi i përgjegjësisë direkt të zyrtarit publik për shkarkime të padrejta nga puna, si përgjegjësi penale, duhet dispozitë e veçantë në kodin penal, por edhe financiar për çdo dëm që i shkaktuarit buxhetit. Fatura e përballimit të dëmit t'i kalojë zyrtarit që ka marrë vendimin e padrejtë. Dëmi nuk mund t'i ngarkohet taksapaguesit shqiptar, që janë të dëmtuarit kryesorë në këtë rast. Kuvendi dhe qeveria të bëjnë çmos që forca e punës të japë kontributin këtu dhe të dekurajojë largimet nga vendi"- deklaroi z.Meta.

BUXHETI

Në 2018 u paguan nga thesari i shtetit rreth 100 milionë euro dëmshpërblime pagash për pushime të padrejta nga puna sipas rasteve të shpërndara në vite të ndryshme gjatë dekadës së fundit. Ndërkohë në Apelin Administrativ akoma nuk kanë mbërritur çështjet e vitit 2017, i cili ishte një vit zgjedhor.



PD pyet Gjonajn: Trego kë shantazhoi Dritan Dajti?

Pas marrjes së vendimit për Dritan Dajtin për uljen e dënimit nga burgim i përjetshëm në 25 vite burg për vrasjen e katër policëve në 2009, PD i kërkoi kryeministrit Rama dhe ministres së Drejtësisë, Gjonaj që t'u përgjigjet disa pyetjeve, të cilat po mbahen të fshehta për opinionin publik. Në pyetjet e drejtuara ministres së Drejtësisë kërkohet shpjegim se më kë ka komunikuar nga burgu Dritan Dajti si dhe kush dhe garancinë për lirimin e tij. "Qeveria vazhdoi talljen e pacipë dhe të pamëshirshme me 4 Dëshmorët e Atdheut, të vvarë në krye të detyrës nga kriminelin Dritan Dajti, për t'u hedhur hi syve shqiptarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë, se vendimi në favor të Dritan Dajtit është prodhim i Edi Ramës. Kërkesa e Ministres së Drejtësisë për procedim disiplinor të gjyqtarëve, në kushtet kur mungon ligji për shkeljen disiplinore, është tallje me shqiptarët dhe një teatër kriminal që nuk ndryshon dot faktin se një tjetër kriminel i rrezikshëm u lirua nga drejtësia e reformuar e Edi Ramës. Në vend të propagandës së neveritshme dhe mashtrimit të pacipë të opinionit publik, ministrja e Drejtësisë ka për detyrë të mos heshtë, por t'u thotë shqiptarëve: Me kë komunikon nga burgu Dritan Dajti? Kë shantazhon nga burgu vrasësi i 4 policëve në krye të detyrës? Kush i ka dalë Dritan Dajtit garant për lirimin e tij të shpejtë? Pyetjet janë konkrete dhe kërkojnë përgjigje konkrete dhe ministrja e Drejtësisë nuk mund të fshihet dot shumë gjatë pas kërkesave që bazohen në ligje që nuk ekzistojnë", - thuhet në deklaratën e PD-së.

TAKIMI

Ambasadori i BE, Luigi Soreca, takoi dje kreun e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Ardian Dvoranin duke i shprehur mbështetjen e Bashkimit Europian për punën e rëndësishme të Këshillit.

INTERVISTA QEVERISJA

Rama: Brenda mandatit zgjidhim çështjen e dokumenteve të pronësisë

Qeveria premton që me anë të ndryshimeve që po bëjnë në riorganizimin e institucioneve që merren me çështjen e pronës në Shqipëri të lehtësojë së pari dhe më pas edhe t'i japë zgjidhje problematike që shoqëron shoqërinë tonë prej afro 3 dekadash. Kryeministri Edi Rama duke folur dje gjatë takimit të përjavshëm me qytetarët që kanë zgjidhur hallet dhe problemet e tyre nëpërmjet platformës së qeverisjes, preku edhe një nga çështjet më të mprehta të tranzicionit, asaj të pronës. Duke iu referuar pikërisht rastit të familjes së vjetër tiranase, Fortuzi, theksoi se qeveria është në



një proces shumë të rëndësishëm reformimi dhe transformimi të agjencive, qoftë të hipotekës, qoftë të ALUIZNI-t dhe paralelisht po

punojmë me gjithë bazën dixhitale të të dhënave.

"Kemi marrë zotimin që deri në fund të mandatit, dokumentet e pronësisë do

të jenë një procedurë shumë e thjeshtë, e drejt-përdrejtë, e dixhitalizuar. Është shumë më e lehtë ta thuash sesa ta bësh, por është një domosdoshmëri dhe besoj që ne do t'ia dalim dhe do të vijë brenda këtij mandati, dita që 'Platforma e Bashkëqeverisjes' do të jetë jo më vendi ku shumica e ankesave lidhen me ALUIZNI-n dhe me ZRPP-në, për arsye të një trashëgimie shumë të rëndë, por vendi ku rastet që lidhen me dokumentet e pronësisë të jenë raste minimale", tha Rama.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Lushnje

Ish-kryeministri shprehet kundër idesë së ndryshimit të kufijve të Kosovës

Mediat kazan, Majko: Rama me 90% e atyre që shan ka qenë shok

"Për herë të parë jam ndjerë i pasigurt"

Ish-kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko thotë se protestat e studentëve ishin shqetësuese dhe tregues i asaj se klasa politike në Shqipëri ka filluar fundin ciklit të saj. Ministri i Diasporës, që ndodhej në Uashington për Mëngjesin e Lutjeve, në një intervistë për VOA-n foli edhe për qëndrimin e kryeministrit Edi Rama ndaj medias dhe për çështjen e negociatave Prishtinë-Beograd.

Zoti Majko, po i afrohem samitit të dytë për diasporën, çfarë hapash konkretë po merren nga qeveria shqiptare për angazhimin e diasporës dhe sa realisht janë të angazhuar shqiptarët që jetojnë jashtë vendit, bazuar në kontaktet që keni ju, për të dhënë kontributin e tyre? Çfarë garancish jep qeveria shqiptare që ata të mund të bëjnë një gjë të tillë?

Dua të theksoj faktin që ky aktivitet është sidomos i diasporës. Nuk do të jetë thjesht një dialog midis një qeverie në pushtet dhe të ftuarve që do të vijnë. Ne jemi të vetëdijshëm se brenda politikës shqiptare ekzistojnë shumë arsye se përse ata që kemi ftuar në samitin e diasporës janë larguar nga vendi. Kështu që jemi shumë të kujdesshëm për të mos bërë sikur po bëjmë ndonjë heroizëm të madh me ato çfarë kemi bërë. Kemi bërë shumë, por mendoj se jemi shumë vonë dhe vrapim në këtë rast është prapë vonë.

Në janar, kryeministri Rama ndryshoi më shumë

se gjysmën e qeverisë, duke e quajtur këtë si reflektim ndaj protestave të studentëve. Kur një kryeministër ndryshon më shumë se gjysmën e qeverisë, çfarë treguesi është ky për ecurinë e qeverisjes që nga koha kur filloi ky mandat i ri i socialistëve dhe në fakt çfarë ka ndryshuar në filozofinë e qeverisjes me ndryshimin e emrave?

Mendoj se të gjithë kemi qenë nën reflektimin se çfarë duhet të bëjmë, pasi lëvizja studentore ishte një lëvizje që realisht na shqetësoi të gjithëve. Unë, të them të drejtën, për herë të parë jam ndjerë i pasigurt për atë që po ndodhte. Sepse nga një anë ndjeja që po takoja vetveten, ata ishin studentë që po ngriheshin karshi, ta themi troç fjalën, një sistemi politik që ishte ndërtaur pas viteve '90-të dhe që një pjesë e tyre mendojnë se është i kalbur, ashtu siç mendoja unë bashkë me shokët e mi në vitet '90-të. Po ta vini re, problemi më i madh aty nuk ishte se ata kundërshtonin qeverinë, madje ata nuk kërkonin as dorëheqje të qeverisë apo të ministrave të veçantë të qeverisë. Shqetësimi im më i madh ishte se ata nuk shikonin veten të përfaqësuar tek



Ish-kryeministri Pandeli Majko

opozita. Dhe kjo sjell një problem të madh të opinionit publik me politikën shqiptare.

Nuk besoj se ishte kjo situata...

Mendoj se kjo ishte një pjesë e situatës. Unë nuk po përpiqem të jem shterues në atë që po shpjegoj. Po them atë që mua më shqetëson më tepër nga gjithë kjo histori. Që do të thotë se sistemi politik nuk po përfaqëson opinionin publik. Një sistem politik që nuk përfaqëson opinionin publik të një ven-

lat më të fuqishme?

Edi Rama përveç se është kryeministër për aq sa e njoh unë, ka qenë edhe një nga penat e gazetarisë shqiptare. Kështu që shpesh ai e ka pak delikate të ndajë pozicionin e tij si kryeministër dhe pozicionin e tij si një njeri që është rritur midis gazetarëve më shumë sesa midis politikaneve dhe ky është fakt.

Ai ka kritikuar shpesh shumë ashpër...

90 për qind e atyre që ai kritikon shumë ashpër, realisht kanë qenë shokë të tij, shokë bile shumë të afërt, një pjesë e tyre e kanë ndihmuar në shkallë të ndryshme të karrierës, siç e thonë tani së fundmi. Ne duhet ta bëjmë këtë diferencë. Për sa i përket mënyrës se si u shpreh ai për "Zërin e Amerikës", unë kam rezervat e mia. Rezervat fillojnë që nga mënyra se si unë e kam marrëdhënien me "Zërin e Amerikës". Por besoj se në të tilla raste, mirëkuptimi është gjëja më e veçantë që ky ekip i veçantë që njoh unë në "Zërin e Amerikës" ka dhe duhet të ketë me politikën shqiptare. Mendoj se "Zëri i Amerikës" e ka atë që ka në gjithë historinë e gjithë medias shqiptare dhe në marrëdhënien me të vërtetën me publikun shqiptar. Edhe kur

Zoti Rama reagon ashpër sa herë që kritikohet nga media, e ka gjetur emrin që përdor shpesh "kazan" dhe së fundmi edhe "Zëri i Amerikës" u bë pjesë e këtij lloji reagimi të kryeministrit Rama. A mendoni se qëndrimi të tilla nga kryeministri janë të arsyeshme duke pasur parasysh se në të gjitha demokracitë, media është një nga shtyll-

ne ndonjëherë e tejkalojmë atë që konsiderohet si e tejkualuar; mendoj se këtu duhet të ketë mirëkuptim dypalësh. Unë e thashë, Edi Rama është një antikonformist dhe shpesh në marrëdhëniet me median ai është më shumë gazetar se sa politikan.

Kalorjmë pak te Kosova. Ditët e fundit ka pasur nxitje, sidomos nga Shtetet e Bashkuara, që të zgjidhen mosmarrëveshjet mes Kosovës dhe Serbisë dhe të arrihet një marrëveshje brenda këtij viti. Gjithashtu, ka pasur shumë debate duke filluar që nga ideja e korrigjimit të kufirit, vendosja e tarifave që po kundërshtohet me forcë nga Shtetet e Bashkuara, tarifat ndaj Serbisë. Si e shihni situatën dhe a jeni optimist për një zgjidhje këtë vit?

Unë pres marrëveshje, siç edhe dy ambasadorët e respektuar kishin nënvizuar, të zbatueshme. Për idenë e shkëmbimit të territoreve, idenë e korrigjimit të kufijve, ide të çuditshme që kanë qarkulluar mbi dhe nën tavolinë, sinqerisht kam qenë i rezervuar. I rezervuar për një fakt shumë të thjeshtë: ky është një lloj autoriteti apo autorizimi që i takon elitës politike të Prishtinës.



Partia Demokratike u ka ofruar aleatëve të vet një platformë konkrete bashkëpunimi, nëpërmjet së cilës synohet të arrihet një koalicion opozitar, që do të luftojë për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme. Nëpërmjet këtij dokumenti që është përgatitur nga Partia Demokratike dhe që do të diskutohet me aleatët e opozitës, përveç krijimit të koalicionit, propozohet që partitë të bien dakord se rruga e vetme për të garantuar zgjedhjet e lira dhe të ndershme është formimi i një qeverie tranzitore, e cila duhet të ketë mandat për 4 çështje kyçe. Më konkretisht, qeveria tranzitore duhet të punojë kthimin e legjitimitetit politik të qeverisjes në vend, nëpërmjet zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Gjithashtu, për krijimin e kushteve të domosdoshme për zgjedhje të lira dhe të ndershme, parlamentare dhe vendore në Shqipëri, përmes dhënies fund të kapjes së shtetit nga krimi i organizuar, oligarkia dhe korrupsioni i lartë shtetëror; realizimin e Reformës Zgjedhore dhe ndjekjen e zbatimit të saj, me fokus të veçantë shkëputjen e lidhjes mes politikës dhe kimit, luftën ndaj fenomenit masiv të blerjes së votave, in-timidimit kriminal mbi zgjedhësit, presionit mbi me-

Draftmarrëveshja/ Basha u propozon aleatëve kandidatët të përbashkët në zgjedhje

Opozita e bashkuar, zbardhen katër pikat e platformës së bashkëpunimit

PD do të negociojë me partitë të tjera jashtë koalicionit



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, me aleatët

KOALICIONI

Ne, opozita e bashkuar, angazhohemi në një marrëdhënie politike dhe elektorale, e cila do të garantojë mundësi për çdo individ dhe parti politike për t'u bërë pjesë e këtij transformimi të rëndësishëm kombëtar, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe integritetit të nënshkruesve të kësaj platforme bashkëpunimi.

e kushteve që sigurojnë zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe për t'i dhënë fund kapjes së qeverisjes dhe zgjedhjeve nga krimi i organizuar dhe paratë e pista të krimiit dhe korrupsionit", - thuhet në këtë platformë. Drafti i hartuar nga PD vlerëson se arritja e kësaj platforme bëhet e rëndësishme në kushtet kur sipas saj, qeverisja aktuale dhe institucionet e drejtësisë nuk kanë ndërmarrë asnjë përpjekje konkrete, për të trajtuar çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës, përdorimit të parave të pista në zgjedhje, si dhe angazhimit në zgjedhje të individëve me të kaluar kriminale, duke cenuar rëndë besimin e publikut në integritetin e zgjedhjeve. Ky dokument është nisëm e kryetarit të Partisë demokratike, Lulzim Basha, i cili, pas arritjes së dakordësisë me partitë parlamentare të opozitës, do ta zgjerojë koalicionin edhe me parti të tjera jashtë parlamentit.

dian, si dhe eliminimin e pabarazisë mes partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje. Gjithashtu, dy çështje të tjera për të cilat duhet të punojë qeveria tranzitore janë: krijimi i klimës së besimit për zba-

timin e Reformës në Drejtësi, jashtë çdo ndërhyrje politike, si dhe krijimi i kushteve të nevojshme për të përshpejtuar nisjen e negociatave të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Europian dhe

THIRRJA



Kokëdhima:
Protestoni për hallet tuaja, jo për PD-LSI

Kryetari i partisë ZGJIDHJA, Koço Kokëdhima, u bëri dje thirrje mbështetësve të partisë që drejton që të dalin në protestën e 16 shkurtit, siç tha ai, jo për PD dhe LSI, por për hallet e popullit. Kokëdhima akuzoi PD dhe LSI se kanë shërbyer si oksigjen për Ramën në krye të pushtetit dhe u kërkoi që, përpara se të thërrasin popullin për të rrëzuar Edi Ramën, të bëhen pra njësh me shqiptarët; të dorëzojnë privilegjet e shumta, të ndahen nga e kaluara e tyre antidemokratike dhe antipopullore, të tërhiqen në mënyrë të njëanshme nga administrimi partiak i zgjedhjeve dhe të kush-tëzojnë përfshirjen në jetën parlamentare me çlirimim e zgjedhjeve, rikthimin e demokracisë dhe shtetit ligjor.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

FOR CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RESCUE AND FIRE FIGHTING STATION (RFFS) BUILDING TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is requesting offers for construction of New Rescue and Fire Fighting Station (RFFS) Building.

TIA is looking to contract a company to undertake this project that will consist in general terms of: securing of the site, preparatory works, soil removal and excavations, drainage works, structural works, interior and exterior finish works, mechanical and electrical systems, external infrastructure including surrounding related pavement works, demolition of existing building and construction of the sport facilities.

To participate in this process interested parties shall submit officially in written form the expression of interest by letter at TIA premises. After receipt of the expression of interest until deadline 15 of February 2019, TIA will provide via email the Invitation to Tender and Confidentiality Commitment Document together with the respective forms. These documents and forms must be submitted filled and signed accordingly to TIA, Administration Building, Rinas, until 18 of February 2019.

Only to the companies that will submit the confidentiality commitment and it's forms, prequalified based to specified qualifying criteria, will be given the respective set of Instruction to Tenderers with tender documents that contain the full information for submission of the offer.

The set of tender documents will be delivered free of charge to the prequalified companies, in a CD, on 20 of February 2019 .

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "CONSTRUCTION WORKS FOR NEW RFFS BUILDING" The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 18 March 2019**. Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
lalimema@tirana-airport.com; fvjoka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com



Basha: Java vendimtare, do çlirojmë vendin nga kriminelët

Kreu i opozitës Lulzim Basha u premtoi dje vlonjatëve dhe lushnjarëve se sapo e djathta të marrë drejtimin e vendit, betejën e parë do ta zhvillojë për çlirimim e ekonomisë nga monopolet, oligarkia dhe korrupsioni. Gjatë një takimi me biznesin në Vlorë z.Basha theksoi se çdo kontratë abuzive e favorizimi i kompanive të caktuara do të marrë fund. "Nuk mundet askush, sado kohë të ketë qenë në paradhomat e PD dhe tani në paradhomat e PS, të vijë dhe të marrë tenderë nga 200-300 milionë euro pa studim fizibiliteti, pas asgjë fare. 5 individë dhe korporatat e tyre kanë lidhur sot duart e buxhetit të shtetit me 2.9 miliardë euro PPP që nuk e dimë çfarë vlere do t'i sjellin ekonomisë. Të gjitha këto kontrata do të anulohen dhe çdo cent publik, që janë paratë tuaja, që kanë ndërruar duar, do të rikthehet tek arka e shtetit. Ne do t'u japim fund këtyre praktikave. Nuk do të ketë propozime të pakërkura, nuk do të ketë kompani fantazmë, që krijohen dy ditë para tenderit, nuk do të ketë tenderë me konkurrencë false ku futet një bedel në të tre lotet dhe pastaj zeron ofertën, që të dalë oferta më e lartë që të marrë 40 milionë euro për 2 km për tenderë si ai i unazës me 40 milionë euro, që janë paratë e shqiptarëve. Platforma antimafla do të godasë këtë element të përparimit të korrupsionit, por ne besojmë se platforma fiskale e takës së sheshtë 9%, thjeshtimit të sistemit fiskal, po kështu, do të ndihmojnë shumë në reduktimin e korrupsionit, duke reduktuar mundësitë për korrupsion", deklaroi z. Basha.

Koncesionet, nga 1 korriku, jo më kontrata PPP në infrastrukturë kur nuk ka një ofertë

Debat për PPP, Shehaj: 70 mln euro për 16 km rrugë. Vijoni të vidhni

Komisioni miraton ndryshimet ligjore për veprat publike

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese diskutoi edhe ndryshimin e projektligjit për koncesionet dhe PPP-të. Ministria e Financave propozoi që nga 1 korriku i këtij viti të mos jepet më asnjë projekt me PPP kur nuk ka një ofertë. Ndërkohë, deputetët e opozitës kanë qenë ata që kanë ngritur dyshime, ndërsa mes tyre deputeti Agron Shehaj ka ngritur shumë pikëpyetje dhe dyshime. Duke u nisur nga fakti se këto ndryshime do të hyjnë në fuqi pas muajit korrik, Shehaj hodhi dyshime dhe kërkoi sqarime nga z.v.ministrja e Financave nëse deri atëherë do të jenë dhënë koncesione të tjera. Ai denoncoi një tjetër rast, atë të dhënies me koncesion të rrugës Orikum-Dukat, kur tha se do të jepen 70 mln euro për 16 km rrugë.

KOMISIONI

Në Komisionin parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese dhe Tregtisë është diskutuar dhe projektligji i ri për koncesionet, në relacionin e të cilit parashikohen ndryshime të reja për kontratat me Partneritet Publik-Privat. Z.v.ministrja e Financave, Albana Shkurta, ka bërë me dije se duke nisur nga 1 korrik 2019 nuk do të lejohen më kontrata PPP në infrastrukturë kur nuk ka një ofertë. "Projektligji vjen si iniciativë ligjore e Ministrisë së Financave. Synimi i tij është përmirësimi i kuadrit ligjor dhe të rrisë kontrollin mbi angazhimet fiskale. Në hartimin e tij janë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet dhe përvojat e dhëna nga institucionet ndërkombëtare si FMN, BB. Në ndryshimet e parashikuara janë heqja e kontratave koncesionare në një sërë sektorësh. Nga 1 korriku 2019 nuk do të lejohen më kontratat PPP të pakërkura në infrastrukturë. Gjithashtu, parashikohet heqja e bonusit për propozimet e pakërkura", - argumenton z.v.ministrja. Lidhur me pyetjet e paraqitura nga deputetët në sallë, z.v.ministrja mohoi të jenë dhënë kontrata PPP për llixhat, ndërsa në lidhje me kontratat për pompat e karburanteve, ajo bëri me dije se nuk është parashikuar tarifë shtesë. Shkurta shton se ndryshimi më i rëndësishëm i parashikuar është eliminimi i iniciativës nga një operator privat për kontrata koncesionare, në rast të një oferte të pakërkuar. Z.v.ministrja tha: "Nuk mohohet dhënia e kontratave të ardhshme koncesionare për rrugët, por vetëm ato në rast se mungon një ofertë zyrtare". E pyetur për efektin në borxhin publik, z.v.ministrja përgjigjet se për vitin 2019 vlera totale e këtyre lloj kontratave është parashikuar 3% të nivelit të të ardhurave.



Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese

NDRYSHIMET

Ligji i ri, i cili do të hyjë në fuqi nga 1 korriku i këtij viti do të sjellë një ndryshim në menaxhimin dhe kontrollin e PPP-ve. Me ligjin e ri nuk do të mund të propozohen nga sektori privat projekte

koncesioni/PPP, përveçse në porte aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror. Gjithashtu, do të shfaqet sistemi i shpërbli-

mit me pikë bonus të propozuesve të pakërkuar dhe do të forcohet roli monitorues dhe kontrolli i MFE jo vetëm gjatë fazës së përgatitjes së projekteve të koncesionit/PPP dhe gjatë zbatimit të kontratave.

PËRPLASJA SHKURTA-SHEHAJ

Albana Shkurta, z.v.ministre e Financave: Çdo proces që ka nisur do vazhdojë në kuadër të ligjit në fuqi

Agron Shehaj: Pra, do vazhdoni të vidhni... Zonja nuk na dha përgjigje, ju jeni mazhoranca këtu, duhet të përgjigjeni.

Lorenc Luka: Pra, po riparoni diçka të gabuar që keni bërë. Mos ndoshta abuzoi ministri i kaluar? Bëri veprime të papërgjegjshme? Duhet të ketë një arsyetim pse sillat sot ky projektligj? FMN dhe opozita prej vitesh kanë kërkuar të ndalohen këto PPP se po rrisnin borxhin publik në mënyrë kriminale.

Albana Shkurta, z.v.ministre e Financave: Puna për përgatitjen e këtij projektligji ka kohë që ka filluar. Ka qenë në diskutime. Në hartimin e këtij projektligji janë marrë parasysh sugjerimet e institucioneve ndërkombëtare, por edhe rekomandimet apo komentet e marra nga ambienti brenda vendit. Ne mendojmë që ky projektligj adreson shtetësimet që kemi marrë. Këto projekte nuk është se nuk do ofrohen më, por eliminohet marrja e iniciativës nga privatët përmes një oferte të pakërkuar.

Ndryshon konfiskimi i pasurive

Agjencia shet mallrat që në momentin e sekuestrimit

Hendeku ligjor dhe mbivendosja e kompetencave të institucioneve për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara ka bërë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë një projektligj për të caktuar një procedurë të qartë për trajtimin e tyre. Drafti që mban firmën e ministres Anila Denaj është hedhur për konsultim dhe synon, të mirëpërcaktojë të gjithë procesin aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themele ligjore procedurën që ndjek Agjencia që nga momenti i parë i ekzekutimit të Vendimit të sekuestros, me marrjen në dorëzim të pasurive që do të administrohen, duke vijuar më pas me menaxhimin e tyre, sipas mënyrave dhe formave specifike në varësi të llojit të pasurisë, e duke mbyllur qarkun e administrimit, me anë të procesit të destinimit përfundimtar të pasurive që konfiskohen. Por ndryshimi kryesor që sjell projektligji "Për administrimin pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara" është edhe shtimi i kompetencës për shitjen e pasurive të luajtshme, të cilat prishen, amortizohen apo u bie vlera shpejt qysh në fazën e sekuestrimit, duke mos pritur vendimin përfundimtar të konfiskimit. Sipas draftit të publikuar nga "SCAN", përdorimi i kësaj procedure do të bënte që vlera e realizuar nga shitja e pasurisë të ruhej në një llogari bankare të veçantë, e në rast revokimi të sekuestrimit t'i kthehej pronarit të ligjshëm, ndërsa në rast konfiskimi të kalonte në buxhetin e shtetit. Financat argumentojnë se shitja e parakohshme e këtyre pasurive të sekuestruara do të sillte një përfitim për të gjithë, pasi jo vetëm ruhet vlera momentale e pasurisë së luajtshme (autoveturë, pajisje teknologjike dhe IT, gjë e gjallë, etj.), vlerë e cila do të humbte fare, në qoftë se këto pasuri do të mbaheshin deri në përfundim të afateve procedurale gjyqësore, por edhe shkurton ndjeshëm shpenzimet e Agjencisë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Shtrënjtimi, nga mungesa e prodhimit, rritja më e lartë nga 2010

Rriten me 37 për qind çmimet e zarzavateve në janar

Cmimet e prodhimeve të stinës, kryesisht perimet dhe zarzavate pësuan rritje jo të zakonshme gjatë muajit janar, teksa INSTAT raportoi se çmimet në grupin "zarzavate, përshi patatet" u rriten me 36.6 për qind, duke shënuar nivelin më të lartë që nga maji i vitit 2010, ku ndryshimi i çmimit për shkallë edhe të krizës globale të asaj kohe arriti në 56.6%. Ndër vite, çmimet e perimeve dhe frutave janë rritur me ritme më të larta se grupet kryesore të shportës së mallrave të konsumit, që INSTAT i referohet për matjen e inflacionit. Kjo për arsye se prodhimet shqiptare nuk plotësojnë nevojat e brendshme dhe shpesh importet e këtyre prodhimeve hyjnë në tregun shqiptar me kosto shtesë. Fermerët janë të shqetësuar se nuk po orientohen që të prodhojnë sipas nevojave të tregut, teksa këtë vit fermerët e pemishëve, sidomos agrume dhe mollë u ndeshën me superprodhim. Kjo gjendje ka sjellë humbje të mëdha, tek-



sa fermerët e Konispolit lanë tonelata me portokalle dhe mandarinë të kalben poshtë pemëve. Në një situatë të ngjashme janë edhe fermerët e mollëve në Korçë. Inflacioni në muajin janar arriti në 1.9 për qind, duke qenë poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1.7%. Rritja e përgjithshme e çmi-

meve në janar u dominua në më shumë se 90 për qind nga rritja e çmimit të ushqimeve. Shqipëria nuk ka projeksione dhe studime në lidhje me pritshmëritë e ecurisë së konsumit në tregun vendës për disa artikuj bujqësore. Vendet të zhvilluara të Europës u japin fermerëve të dhëna të sakta mbi ecurinë e konsumit dhe sasive të prodhuara për periudha mbi 10 vite. Ndërsa Shqipëria vuan edhe nga një handikap tjetër, ku lejohen importet e prodhimeve bujqësore në kulmin e sezonit në Shqipëri. Teksa mollët dhe mandarinat shqiptare po kalben në fusha, njësitë e shitjes me mallra importi, molla dhe portokalle që vijnë nga Greqia dhe Italia.

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G. Bailiff Service" me përbarimtarë gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyta 8, Ap 1, Tiranë, ngjofen se më datë 06.03.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i llojit për shitjen e pasurisë së paluajtshme. Apartamenti me sipërfaqe totale 45.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28-1-25, Vol.13, Fq.41, Zk.3976 në pronësi të Hipotekësistit shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skozë, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 10,147.2 (Dijetë mbi e njëqind e dyzet e shtatë pikë dy) EUR dhe Apartamenti me sipërfaqe totale 63.3 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 56/28-1-26, Vol.13, Fq.42, Zk.3976 në pronësi të Hipotekësistit shoq. Sina Konstruksion 2008 sh.p.k me adresë Skozë, Tiranë me vlerë fillestare në ankand 14,179.2 (Katërmijëdijetë mbi e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë dy) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888, email enuar.merko@gmail.com

LEGALIZIMET DOSJET ME MANGESI

Dosjet me mangësi, 51 personat që ndërtuan pa leje dhe duhet të plotësojnë dokumentet

Tiranë, ALUIZNI: 250 personat që kanë gati lejet e legalizimit

Përfituesit në zonat përreth kryeqytetit

ALUIZNI publikon listën me 250 personat që kanë gati lejet e legalizimit në qarkun e Tiranës. Pronarët që kanë gati lejet janë në 11 njësitë e kryeqytetit dhe në zonat përreth. Përfituesit duhet të tërheqin lejet e legalizimit dhe më pas presin që Agjencia e Legalizimeve të ndjekë procedurën për pajisjen e tyre me certifikatën e pronësisë. Gjithashtu, ALUIZNI publikon edhe listën me 51 persona që kanë ndërtuar pa leje, por që duhet të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për legalizimin e shtëpive.

TAPIA
Procedurat për marrjen e tapisë janë ndjekur nga ALUIZNI, i cili dorëzon

dosjen e plotë në Hipotekë, por përfituesit duhet të shkojnë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në

Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga 'Agjencia'. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion

banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të

146	Elbasan	VANGJELICA ALI XIBRAKU	35	273	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	397	Korçë	MONIKA XHEZMI XHEMOLLARI	54
147	Elbasan	VJOLA ANDREA ZACE	47	274	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	398	Korçë	OLGES THOMA SHUMBELLA	51
148	Elbasan	XHOANA DENIS HOXHA	50	275	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	399	Korçë	OLTI LAVDERIM RUSHITAJ	30
149	Elbasan	XHOANA QEMAL JAUPI	36	276	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	400	Korçë	ORNELA ANON BODURRI	45
150	Elbasan	XHOANA QEMAL JAUPI	38	277	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	401	Korçë	ORNELA BEHAR BABOCI	41
151	Elbasan	YLBER BEHAR BABOCI	32	278	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	402	Korçë	ORNELA RAMADAN PRONJARI	40
152	Elbasan	ZAMIRA NAIM SHKALLA	28	279	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	403	Korçë	REDINELA HYSEN HYKELLARI	47
153	Fier	JONIDA ASTRIT BANI	35	280	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	404	Korçë	REDION FERIDON SHEMBI	45
154	Fier	ADELAJDA BESNIK BALI	50	281	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	405	Korçë	RESMIE PETRIT HYKA	33
155	Fier	AFIJE JONUS SHANAJ	26	282	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	406	Korçë	ROLAND ISUF PANCI	36
156	Fier	AGELA BAJO BRAHIMI	42	283	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	407	Korçë	ROMINA TAHIR NELI	48
157	Fier	ALBI BUJAR MEÇAJ	41	284	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	408	Korçë	SABINA ISUF BUKOLLI	41
158	Fier	ALBINA AHMETI SNAKA	25	285	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	409	Korçë	SEFI MERSIN SHABANLLARI	47
159	Fier	ALBULENA FETAH PEKA	48	286	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	410	Korçë	SIDORELA DASHNOR NEZIR	22
160	Fier	ALKETA BUJAR POSHNJARI	35	287	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	411	Korçë	SIDORELA ROLENC LAME	27
161	Fier	ALMEND YLLI SILOJ	42	288	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	412	Korçë	SOKOL HIQMET NAKE	21
162	Fier	ANA SAZAN TROKA	40	289	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	413	Korçë	STIVJONA VANGJEL SHKEMBI	31
163	Fier	ANILA NAZMI MEÇE	29	290	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	414	Korçë	Emër Atësi Mbiemër	Piket
164	Fier	ANISA KASTRIOT MUSKAJ	29	291	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	415	Korçë	SUELA SEZAT HOXHA	43
165	Fier	ANITA AGIM MUSKO	41	292	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	416	Korçë	TEO PETRO FERRAKLARI	41
166	Fier	ANKELA SERIAN ISUFAJ	40	293	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	417	Korçë	THIMOJA PANDELI KARAPANXHO	26
167	Fier	ANSUETA AGRON HOXHAJ	43	294	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	418	Korçë	TIZINELA VASIL DEVOLLI	45
168	Fier	ARJOLA MIHAL NUSHI	37	295	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	419	Korçë	VALENTINA FATI DAPPELLARI	41
169	Fier	ARLIND SOKRAT BANI	37	296	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	420	Korçë	VANDRIAS VALTER AGOLLI	36
170	Fier	ARLINDA DËRVIKSH DËRVIKSHAJ	38	297	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	421	Korçë	VASILIKA ILIA MALAVECI	40
171	Fier	ARMAND AGIM XHELAJ	54	298	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	422	Korçë	VASILIKA XHEMAL BEGA	31
172	Fier	ARMELA LLAZAR MILE	43	299	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	423	Korçë	VILMA MUHAMET DOKOLLI	43
173	Fier	ARMELA NEKI TATA	50	300	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	424	Korçë	VJOLA PETRIT DRAGOVI	43
174	Fier	ASLLAN HAZBI LUKA	22	301	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	425	Korçë	VOJSAVA ZYLLAJ ROVI	48
175	Fier	BAJAME BUJAR HAJDARI	27	302	Fier	MARINELA BEDRI ALUSHAJ	46	426	Korçë	XHENI N	

Vendimi, ja si votuan pesë gjyqtarët për Dritan Dajtin

"Dajti", ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj: Të shkarkohen 3 gjyqtarët! Nuk ndalemi këtu

TIRANË - Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, i ka kërkuar dje përmes një deklaratë për shtyp institucionit të ri të Reformës në Drejtësi, Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndëshkimin e tre gjykatësve, të cilët bënë kalimin e vendimit për Dritan Dajtin nga burgim i përjetshëm, në 25 vite heqje lirie për akuzën e vrasjes së katër policëve në gusht të vitit 2009. Ajo u tregua besimplotë se KLGJ-ja do të veprojë në kohë të shpejtë ndaj tre gjyqtarëve, të cilët sipas saj, kryen një akt të paprecedentë me vendimin e marrë. "Jam sërish këtu para jush për të folur ndaj vendimit të paprecedentë të dhënë nga Gjykata e Krimeve të Rënda ndaj shtetasit Dritan Dajti. Ministria e Drejtësisë ka kryer të gjitha verifikimet paraprake. Nga verifikimet rezultoi se tre anëtarë nga pesë gjithsej kanë vendosur uljen e dënimit me 25 vite. Për



Dritan Dajti

këtë arsye i jam drejtuar KLGJ-së për marrjen e vendimit të shkarkimit të tre gjyqtarëve. Jam besimplotë se KLGJ-ja do të veprojë shpejt për procedimin disiplinor. Reagimi i qeverisë

nuk ndalet as këtu, por edhe as me kaq", tha mes tjerash Gjonaj. Reagimi i numrit një të Ministrisë së Drejtësisë vjen pas vendimit të marrë të premten që shkoi nga Gjykata e Apelit për Krime

të Rënda. Kjo gjykatë vendosi të heqë burgimin e përjetshëm për Dritan Dajtin dhe dënimin e tij vetëm me 25 vite burg për akuzën e vrasjes së katër policëve pranë plazhit "Iliria" në Durres më 7 gusht të vitit 2009. Ndërsa prokuroria përgatiti rekursin, "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë vendimin e gjyqtarëve për këtë rast. Pro këtij vendimi rezultoi të kenë votuar Aleks Nikolli, Petrit Aliaj dhe Skënder Damini, kurse gjyqtarët nga Fuat Vjerdha dhe Lindita Hoxha kanë votuar pjesërisht kundër vendimit. Trupa gjykuese që dha vendimin për Dritan Dajtin përbëhej nga Fuat Vjerdha, kryetari i Gjykatës së Apelit në Shkodër, ndër-



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

sa anëtarët janë: Lindita Hoxha e Aleks Nikolli, gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ndërsa, pesëshja e gjyqtarëve u plotësua me dy gjyqtarët e tjerë, Petrit Aliaj dhe Skënder Damini, të cilët janë gjyqtarë të Apelit në Vlorë. Sipas vendimit, pro këtij vendimi kanë votuar Aleks Nikolli, Petrit Aliaj dhe Skënder Damini, ndërsa

Fuat Vjerdha dhe Lindita Hoxha kanë votuar pjesërisht kundër. Më e qartë në vendim ka qenë gjyqtarja Lindita Hoxha, e cila përveç togfjalëshit "pjesërisht dakord", ka bërë edhe shënimin lënie në fuqi të dënimit për Dritan Dajtin, i cili më herët ka qenë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda 4 dënime me burgim të përjetshëm.

Nëna e minores: Në polici nuk na e pranuan denoncimin, Bajrakurti na kërcënoi

Ngacmoi seksualisht 15-vjeçaren, përfundon në pranga efektiv i policisë në Malësi të Madhe

SHKODËR

Pak ditë pas skandalit në Kavajë, ku një minorene u abuzua seksualisht përmes kërcënimit të publikimit të një video intime, një tjetër rast i rëndë shantazhi dhe abuzimi ndaj të miturve është denoncuar nga qarku i Shkodrës. Kësaj here autori është një efektiv policie, i cili ka përfunduar në pranga pas zbulimit të një skandalit seksual ndaj një vajze 15-vjeçare. Bëhet fjalë për shtetasin Berhan Bajrakurti, specialist i policimit në Komunitet në Gruemirë, në Komisaratin e Policisë së Malësisë së Madhe, i cili u arrestua një orë pas denoncimit që nëna e vajzës bëri në media, duke publikuar edhe video teksa inspektori i zonës i tregonte organin gjenital së bijës në video telefonata. Vajza 15-vjeçare e ka filmuar këtë moment, duke e paraqitur si një provë të fortë në polici, ku u bë edhe kallëzimi. "Në Shkodër është arrestuar menjëherë punonjësi i policisë që është shfaqur në video e publikuar në media", - thuhet në një reagim të shkurtër nga policia. Nëna e saj është shprehur për portalin "Newsbomb" se Bajrakurti i kishte kërcënuar në Komisaratin e Koplikut ku shkuar për ta denoncuar, ndaj ajo u detyrua ta bënte publik rastin. Më pas, nëna ka thënë se ka shkuar të takojë drejtorin e Policisë Shkodër, por nuk ia ka dalë dhe atje i kanë thënë jozyrtarisht se s'duhet të merret me malësorët se ata janë të paprek-



Efektiv i policisë, Berhan Bajrakurti

shëm. Sipas nënës, inspektori i Gruemirës, një burrë i martuar dhe me fëmijë, e përndiqte vajzën e saj duke e ftuar të hipte në makinë si dhe i dërgonte video me veprime të turpshme. Ndërkaq, mësohet se shumë vite më parë dhe konkretisht në vitin 2008, Berhan Bajrakurti është shkarkuar nga radhët e policisë për shkelje në detyrë. Sipas burimeve të "GSH", ai është rikthyer në detyrë në vitin 2015, ndërkohë që ditën e djeshme u pranngos nga kolegët për ngacmimin seksual ndaj minores. Gjithashtu, mësohet se në zgjedhjet lokale të 2015-ës, Bajrakurti ka qenë komisioner i Partisë Socialiste në Malësinë e Madhe dhe menjëherë pas përfundimit të procesit zgjedhor, ai është rikthyer në detyrë.

Ngacmoi vajzën, Spahia: Polici ishte i larguar, por e riktheu PS

TIRANË - Pas arrestimit të efektivit të policisë për ngacmimin seksual ndaj një minoreneje, ka reaguar në lidhje me këtë ngjarje të rëndë deputeti i PD-së, Bardh Spahia, i cili shprehet se ky është rasti më flagrant se si funksionon shteti. Me anë të një statusi në rrjetin social "Facebook", Spahia jep detaje të tjera për Bajrakurtin. Ai shprehet se i arrestuari ishte i prekur nga dekriminalizimi, por u rikthye sërish në detyrë nga persona me influencë brenda Partisë Socialiste. "Rasti i Malësisë së Madhe është




rasti më flagrant se si funksionon sot shteti. Shefi i komisarariatit, Berhan Bajrakurti, i larguar nga dekriminalizimi kthehet në detyrë nga personat më të rëndësishëm politik të Partisë Socialiste të

Malësisë së Madhe. Sigurisht që ish-komisioneri i PS në zgjedhjet e qershorit 2015 ishte i domosdoshëm për mazhorancën e lidhur me krimin. Është e murrshme dhe thellësisht kriminale përpjekja e kupolës së policisë së Malësisë së Madhe dhe Policisë së Shkodrës për ta mbuluar këtë ngjarje nëpërmjet kërcënimeve të denoncuesve. Tashmë është bindje e thellë që ky është modeli dhe standardi i "rilindjes". Duhet zhdukur një orë e më parë kjo bandë e neveritshme kriminale", shkruan ai.

Petrit Vasili: Lleshaj, dorëhiq!

Në lidhje me ngjarjen e rëndë në Shkodër ka reaguar përmes "Facebook"-ut edhe kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. Ai ka rikthyer në kujtesë fjalët e ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj në emisionin "Opinion" pas emërimit në këtë post. Duke i bashkangjitur me disa sekuenca të videos së policit në Malësi të Madhe, Vasili i kërkon ministrit Lleshaj dorëheqjen. Madje, Vasili e quan të kryer këtë pjesë. "Pse e vonon dorëheqjen Lleshaj? Shiheni në video se si i merr përsipër vetë përgjegjësitë ministri i Brendshëm, Lleshaj. Me siguri do ta ketë dhënë dorëheqjen pas ngjarjes së fundit të turpshme të policisë në Malësinë e Madhe. Ja, shiheni vetë ç'ka thënë i intervistuar nga Fevziu", shkruan ai.



Reagon Lleshaj: Identifikohem me policët që sot

arrestuan një pervers TIRANË - Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, ka reaguar pas akuzave të opozitës lidhur me policin e Malësisë së Madhe, i arrestuar pas veprimeve të turpshme me një 15-vjeçare. Lleshaj shkruan në një postim në "Twitter" së policët nuk janë të tij, por të Shqipërisë. "Policët nuk janë të Lleshaj, por të Shqipërisë. Lleshaj identifikohet pa dyshim me policët që sot arrestuan një pervers, me policët që sakrifikojnë natë e ditë duke shërbyer. Një pervers mund të shërbejë si flamur për politikanë perversë, por nuk mund të njoslosë askënd përveç vetes së tij dhe atyre që i gëzojnë ekzistencën së tij. Mbështetje për Policinë e Shtetit Shqiptar?"

Fanset surprizojnë ish-ministrin e Brendshëm, bluzë me foton e tij

Saimir Tahiri korr fitoren e parë ndaj prokurorisë: Kësaj maratone po i vjen fundi

Gjykata i vendos afat deri më 10 mars organit të akuzës nëse çështja do kalojë për gjykim, apo do të mbyllë hetimet

TIRANË

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, i dyshuar për lidhje me grupin kriminal "Habilaj" korr dje fitoren e radhës në përballjen me drejtësinë. Gjykata për Krime të Rënda pranoi kërkesën e Tahirit për moszgjatjen e hetimeve edhe me tre muaj të tjerë, duke i vendosur kohë prokurorisë deri më 10 mars për të vendosur përfundimisht nëse do kalojë në gjykim, apo do të mbyllë hetimet. "Mua më duket se kësaj maratone po i vjen fundi. Dhe për mua, dhe për prokurorinë nisi numërimi mbrapsht. Kam pasur durim dhe kam ende durim, pa u shqetësuar për asnjë çast, ashtu siç kam forcën për t'u shpjeguar më në fund të gjithë qytetarëve, edhe atyre që më kanë besuar, edhe atyre që ndoshta kanë dyshuar tek unë, të vërtetën time deri në germen e fundit", u shpreh ish-ministri i Brendshëm në një deklaratë për mediat. Më 17 janar, Prokuroria për Krime të Rënda i zgjati me tre muaj afatet e hetimit për ish-zrytarin e lartë, të cilin po e heton që prej tetorit 2017, për akuzën e trafikut ndërkombëtar të narkotikëve, me argumentin se mbetej në pritje të letërproposive dërguar në Itali e Mal të Zi. Por, përgjatë dy seancave të zhvilluara me dyer të mbyllura, burimet thanë se ish-ministri dhe mbrojtësi i tij ligjor, Maks Haxhiaj, këmbëngulën për shfaqimin e vendimit përdoris sipas tyre, prokuroria ka pasur kohën e nevojshme për të kryer të gjitha veprimet hetimore. Gjyqtarja Liljana Baku e pranoi pjesërisht kërkesën e ish-ministrit, çka do të thotë se brenda 30-të ditëve prokurorët duhet të thonë fjalën e tyre, nëse do të ngrënë akuzë zyrtare ndaj



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda

Saimir Tahirit, apo do ta pushojnë çështjen penale ndaj tij. Deri atëherë, Saimir Tahiri tha se do të presë me durim, ndonëse siç deklaroi për muaj të tërë ka mbajtur mbijetuar akuzat të padrejta. Nga dyert e Gjykatës për Krime të Rënda, ish-ministri falënderoi të gjithë mbështetësit e tij, por edhe ata që kanë qenë mosbesues. "I falënderoj të gjithë pa masë, sepse më kanë treguar se ia vlen të presësh, për atë ditë kur vjen drejtësia", tha Saimir Tahiri. Ndërkaq, gjatë seancës së kaluar, ish-ministri i Brendshëm akuzoi

prokurorinë se kjo situatë ka kaluar çdo limit të pranueshëm. "Nuk më ka humbur durimi, kam një vit e disa muaj që pres pa komentuar veprimet e prokurorisë. Pres që t'i shkoj drejtësisë deri në fund, pa bërë siç kanë bërë të tjerët, që janë akuzuar për vjedhje dhe për vrasje. Por çdo gjë e ka kapërcyer çdo limit të pranueshëm. Kjo mjegullnajë dyshimesh nuk mund të vazhdojë më. Pavarësisht se hetimet janë zgjatuar 5 herë, nuk kam folur por, tani po kërkoj që kjo të mos ndodhë më. Çështja duhet të marrë zgjidhje në një



Fanset e Tahirit në ambientet para gjykatës

mënyrë dhe një tjetër. Drejtësia e vonuar nuk është më drejtësi. Kur kjo ndodh me mua, imagjino për të tjerët që s'kanë mundësi, që përplasen dyerve të gjykatave dhe s'kanë mundësi të thonë gjë", u shpreh Saimir Ta-

hiri. E ndërsa në Gjykatën e Krimeve të Rënda po zhvillohej seanca gjyqësore, jashtë ambienteve të këtij institucioni kanë qenë edhe dy gra, të cilat edhe kësaj here i kanë shprehur mbështetje Samir Tahirit, ndërsa mbanin veshur bluzë me foton e tij.

ANKIMIMI

Më 6 shkurt të këtij viti u shty seanca për ankimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, kundër zgjatjes me tre muaj të hetimeve. Kjo, pasi Gjykata e Krimeve të Rënda ka kërkuar dokumente që prokurorët e çështjes nuk i kishin. Menjëherë pas seancës me dyer të mbyllura, ka qenë vetë Tahiri që ka deklaruar këtë fakt përpara kamerave. "S'kam komentuar asnjë veprim të prokurorisë, por pres që t'i shkojë drejtësisë deri në fund. Unë kam pritur dhe do pres deri në fund, pavarësisht se gjithçka që po ndodh e ka kaluar çdo limit të paarsyeshëm", deklaroi Tahiri.



Akuza për bashkëpunim me Habilajt, shtyhet seanca gjyqësore për Jaeld Çelën

TIRANË - Ish-shëf i Policisë së Vlorës i dyshuar si garantor i grupit "Habilaj" në trafikun e drogës, Jaeld Çela, ditë më parë iu drejtua me anë të avokatit Gjykatës së Krimeve të Rënda, ku kërkoi mbylljen e hetimeve ndaj tij. Por, pas ankimit të shtyrjes së hetimeve, dje ka ardhur një përgjigje nga organi i akuzës, i cili njofton se ankimi është caktuar më 14 shkurt. Ndërkohë, avokati i tij ka theksuar se kërkon kohë të njihet me provat. Jaeld Çela vijon të jetë në arrati prej më shumë se një viti, ndërsa Krimet e Rënda do të shqyrtojnë kërkesën e tij në datën 14 shkurt, pavarësisht se më 30 janar u caktua të jetë data e dëshme. Ish-zrytari i policisë është shpallur në kërkim, bazuar në një masë sigurie "Arrest në burg" në mungesë, në nëntor 2017. Sipas hetimeve, ish-drejtori i policisë ka mbajtur në përdorim 3 numra telefonor, në të cilat rezultojnë se ka komunikuar me Florian Habilajn dhe Gentian Cekën, që është shoferi i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri.

Panik në Tiranë, gruaja tenton të hidhet nga kati i 8-të i pallatit

TIRANË - Panik në kryeqytet. Një grua ka kërkuar të hidhet nga kati i tetë i një pallati në zonën e Pazarit të Ri në Tiranë dhe shkak për këtë është bërë një vendim i Përmbarimit që e detyron të largohet nga banesa. Gruaja qëndroi aty prej orës 10:15, ndërsa pas negociimit të policisë me Përmbarimin për të zgjatur afatin e ekzekutimit të vendimit me 10 ditë, zonja e shtëpisë ka zbritur. Djali i saj, Tajar Trroka ka sqaruar se ata janë në një proces gjyqësor me bankën, por ndërkohë, më 28 janar janë njohur nga Përmbarimi me vendimin se duhet të lirojnë banesën. "Banesën nuk e kishim lënë për kolateral, por banka e shtoi pa ankand, pa na njoftuar. Kemi punuar një jetë të tërë për këtë banesë", - tha ai.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë për një periudhë tre vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 9,720,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 07 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Takimi me krerët e shtetit, Haradinaj zbulon bisedimet

Zëvendësministri i Mbrojtjes së Kosovës: Kosova do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s

Zëvendësministri i Mbrojtjes së Kosovës, Burim Ramadani, është shprehur i bindur se Republika e Kosovës do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s. Në një intervistë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se për këtë synim Kosova duhet të thellojë përpjekjet politike dhe diplomatike. Ramadani ka mohuar çdo mundësi që taksa për mallrat serbe ndikon në raportet e FSK-së me SHBA-në. Sipas zëvendësministrit të Mbrojtjes, këto dy gjëra nuk janë të lidhura mes



tyre. "Partneriteti strategjik special me SHBA-të nuk është ad hoc, por i qëndrueshëm dhe i përgjithmonshëm", ka thënë Ramadani. Ramadani bëri

BURIM RAMADANI

"Partneriteti strategjik special me SHBA-të nuk është ad hoc, por i qëndrueshëm dhe i përgjithmonshëm. Skena politike dhe institucionale duhet të reflektojë edhe një herë përkushtimin për të avancuar, mbrojtur dhe garantuar shtetin e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008," ka thënë Ramadani.

thirrje që tërë skena politike dhe institucionale të reflektojë edhe një herë

përkushtimin për të avancuar, mbrojtur dhe garantuar shtetin e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008. Ndërkohë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka folur rreth takimit të djeshëm që kishte me gjithë krerët e shtetit, ku tha se temë e diskutimit ka qenë platforma e dialogut. "Ajo që u arrit si dakordim ishte që platforma kurdo që është e gatshme t'i paraqitet parlamentit", tha ai. Ndërsa, kreu i qeverisë së Kosovës ishte i qartë sa i përket taksës, ku ritheksoi se ajo do të qëndrojë. I pyetur nga gazetaret, Haradinaj foli dhe për anulimin e vizitës të gjeneralit amerikan, ku tha se nuk i di arsyt, ndër-

sa në mënyrë zyrtare theksoi se nuk ka marrë asnjë konfirmim për anulime të vizitës. Këto komente, kryeministri Haradinaj i bëri nga qyteti i Pejës. Qeveria e Kosovës, më 21 nëntor të vitit të kaluar, ka vendosur taksën doganore prej 100% mbi prodhimet e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Autoritetet e Serbisë kanë thënë se nuk do të vazhdojnë dialogun me Kosovën, në rast se taksa për produktet e Serbisë nuk hiqet nga qeveria e Kosovës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar nga institucionet e Kosovës që ta pezullojnë këtë vendim.

Letra e Orr: SHBA po shqyrton të pezullojë programet trajnuese për FSK

Taksa ndaj Serbisë, gjenerali amerikan anulon vizitën në Kosovë

"Zemra ime i takon shtetit të kosovarëve si shtëpia ime e dytë"

Timothy Orr, gjenerali amerikan ka vendosur të anulohet vizitën në Kosovë, në shenjë pakënaqësie me vendimin e qeverisë së Kosovës, për vendosje të taksës në produktet e Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Lajmi është njoftuar nga kreu i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, i cili ka vënë në dijeni Presidentin Thaçi për anulimin e vizitës. Në letër ai shkruan se Washingtoni është duke shqyrtuar edhe masa të tjera, përfshirë këtu pezullimin e programeve trajnuese dhe edukative për FSK-në. Vizita e gjeneralit amerikan në Kosovë ishte parashikuar në datat 16-18 shkurt, në kuadër të 11 vjetorit të pavarësisë. Taksa 100% e vendosur nga qeveria e Kosovës për importet serbe është parë nga SHBA-ja dhe BE-ja si pengesë për dialogun mes dy vendeve. Ndërkaq ka qenë komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rrahman Rama, i cili ka njoftuar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një letre se qeveria amerikane ka marrë vendim që të anulohet vizitën e gjeneralit amerikan të Gardës Nacionale të Iowas, Timothy Orr në Kosovë, në shenjë pakënaqësie me vendimin e qeverisë së Kosovës, për vendosje të taksës në produktet e Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Në letër e komandantit Rama, thuhet se zyrtarët amerikanë në Kosovë e kanë njoftuar atë se Washingtoni është



të duke shqyrtuar edhe masa të tjera, përfshirë këtu pezullimin e programeve trajnuese dhe edukative për FSK-në. Lajmin për anulimin e vizitës së gjeneralit për shkak të taksës e ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë edhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë. Qeveria e Kosovës ka vendosur taksë prej 100 për qind në importet e këtyre dy shteteve. Deri më tani nuk ka pasur ndonjë reagim nga qeveria e Kosovës. Kjo taksë, është parë nga SHBA-ja dhe BE-ja si pengesë për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ambasada e Shteteve të Bashkuara ka thënë javë më parë përmes një deklarate se veprimet që minojnë dialogun, përbëjnë qëndrim kundër interesave të SHBA-së. "Shtetet e Bashkuara insistojnë se ve-

primet që minojnë dialogun, pengesat nga anash, dhe refuzimi për të pezulluar tarifën - gjitha këto shkojnë kundër interesave të SHBA-ve", ishte thënë në deklaratë. Kjo masë është shfrytëzuar nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq si arsytim për mosvazhdim të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, që zhvillohet me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian në Bruksel. Përveç tjerash, edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka thënë të premtën, pas një vizite që ka zhvilluar në SHBA, se Uashingtoni ka dhënë porosi të qartë se pa pezullimin e tarifës doganore nuk mund të vazhdojë dialogu në Bruksel. Përdryshe, deklaratat e ambasadës amerikane, nuk ka shënuar herën e parë që SHBA-ja ka kundërshtuar vendimin e autoriteteve të

TIMOTHY ORR
"Zemra ime do t'i takojë çdo herë Kosovës. Kjo është shtëpia ime e dytë. Shtetet e Bashkuara insistojnë se veprimet që minojnë dialogun, pengesat nga anash dhe refuzimi për të pezulluar tarifën - gjitha këto shkojnë kundër interesave të SHBA-ve", - tha gjenerali Orr.

Kosovës. Departamenti Amerikan i Shtetit, ka bërë të ditur në muajin nëntor se Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo u ka bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që të heqin dorë nga kjo masë. Më 8 maj të vitit të kaluar, në Kosovë kishte qëndruar një delegacion prej 50 anëtarësh nga Iowa e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në krye të së cilit ishte edhe Timothy Orr, Gjeneral i Gardës Kombëtare të Iowas. Ai kishte thënë atëherë se në partneritetin me Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili kishte nisur në mars të vitit 2011, ishte ecur shumë përpara. Partneritetin me Kosovën, gjenerali Orr e konsideronte më të mirin nga 77 partneritetet që ka Iowa në të gjithë botën. "Zemra ime do t'i takojë çdo herë Kosovës. Kjo është shtëpia ime e dytë", pati theksuar gjenerali Orr.

SHKURT

Triumfi i Dua Lipës, Ramush Haradinaj: Kosova është me fat

Fitohja e këngëtares me origjinë kosovare, Dua Lipa në çmimin prestigjioz "Grammy Awards" ka bërë krenarë të gjithë shqiptarët. Por ky sukses nuk kishte se si të kalonte në heshtje në vendin e origjinës. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj me anë të një statusi në rrjetin social "Facebook" shkruan se Dua Lipa, është shembulli i suksesit që me punë dhe talent arrihet çdo gjë. Ai thekson se shteti i Kosovës është me fat që përfaqësohet në botë me talentin dhe emrin e këngëtares. "Dy herë fituese e çmimit prestigjioz "Grammy Awards", Dua edhe njëherë e dëshmoi që me punë dhe talent, kalon çdo kufi. Urime Dua! Kosova është me fat që në botë, përfaqësohet me emrin tënd. RH", shkruan kryeministri.

Vuçiq: Do tentojmë kompromis me Kosovën nëse shfuqizohet taksa

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka thënë se shteti i tij gjithmonë do të tentojë që të bëjë kompromis me Kosovën vetëm nëse kjo e fundit e shfuqizon taksën që ka vendosur ndaj mallrave serbe. "Ne po presim që të shfuqizohen këto tarifa të pavlera. Nëse nuk i ndalojnë ato, do të jetojmë me këtë problem, do të jetojmë me këto probleme dhe do të ndihmojmë popullin tonë në Kosovë, e nëse i heqin ato, ne gjithmonë do të përpigemi të bëjmë një kompromis, por kurrë nuk do të lejojmë që askush të shkatërrojë Serbinë dhe të mendojë se Serbia është e vogël dhe e dobët dhe se mund ta poshtërojë atë që nga 2012-ta"-ka thënë djë Vuçiq, i cili shtoi se ai nuk mund të flasë si të tjerët pasi thotë se nuk është gënjeshtar. "Ne do të punojmë së bashku", tha tutje Vuçiq, duke shtuar se Serbia gjithmonë do të tentojë të bëjë kompromis me kosovarët, nëse shfuqizohet taksa doganore. Ndryshe që nga 21 nëntori i vitit të kaluar, qeveria e Kosovës kishte futur në fuqi taksën prej 100 për qind për mallrat serbe dhe boshnjake, kurse më vonë, qeveria kishte marrë vendim që në këtë taksë të përfshihen edhe brendet e njohura botërore, të cilat hyjnë nga këto dy shtete. Që nga vendosja e taksës Serbia ka bllokuar edhe bisedimet me Kosovën. Ndërkaq heqjen apo pezullimin e taksës nga Kosova e kanë kërkuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe Bashkimi Evropian, pasi në këtë mënyrë sipas tyre mund të vazhdohet edhe dialogu me Serbinë.

Krerët e shtetit, takim për dialogun

Së shpejti do të dërgohet për votim në Kuvendin e Kosovës platforma për dialogun me Serbinë. Kjo është konfirmuar nëpërmjet një komunikate për media, pas takimit që kanë pasur krerët e shtetit në zyrën e kryeparlamentarit Kadri Veseli. Në takim, bashkëkryesuesi i ekipit shtetëror të dialogut Fatmir Limaj ka thënë po vetëm për platformën e dialogut me Serbinë. Serbia e ka stopuar dialogun me Kosovën duke kërkuar fillimisht heqjen e taksës. Ndërkohë edhe marrëdhëniet ndërmjet Kryeministrit Haradinaj dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë tensionuar pikërisht për shkak të taksës së vonë nga qeveria ndaj produkteve serbe. Pikërisht për këtë arsye edhe një gjeneral amerikan ka anuluar vizitën në Kosovë.

Ndihmat humanitare amerikane për Venezuelën, Maduro i bllokon

Guaido: Ky është gjenocid, krim kundër njerëzimit dhe për këtë do të mbahet përgjegjësi

Disa kontenerë kanë bllokuar prej disa ditësh urën kryesore të autostradës që lidh Venezuelën me Kolumbinë. Ushtarët besnikë të presidentit Maduro i kanë vendosur për të penguar hyrjen e ndihmave humanitare amerikane për popullsinë civile. Lideri opozitar Huan Guaido, të cilin perëndimi e njeh si president të përkohshëm, akuzoi regjimin se me këtë veprim po kryen një krim kundër njerëzimit.



HUAN GUAIDO

"Ky është gjenocid. Ka njerëz që janë përgjegjës për këtë dhe regjimi e di mirë. Ky është krim kundër njerëzimit dhe për këtë do të mbahet përgjegjësi", ka thënë i indinjuar presidenti i përkohshëm, Huan Guaido.

"Ky është gjenocid. Ka njerëz që janë përgjegjës për këtë dhe regjimi e di mirë. Ky është krim kundër njerëzimit dhe për këtë do të mbahet përgjegjësi". Por, presidenti

majstist, Nikolas Maduro sheh komplot të fshehur për të rrëzuar qeverinë e tij, pra kamionëve amerikanë me ndihma. E teksa ushtarakët po i dezertojnë, siç është rasti i Alberta Himeneth që bëri apel për lejimin e ndihmave humanitare, Maduro u shfaq duke vizituar nisjen e atyre që regjimi dhe aleatët rusë i konsiderojnë se stërviçet më të rëndësishme në histori. Gatishtëria është në nivelin maksimal për çdo të papritur që mund të sjellë një ndërhyrje ushtarake amerikane.

SHKURT

Indonezi, në një qeli me gjarprin 2 metra të gjatë

Policia indoneziane ka kërkuar falje për përdorimin e një gjarpri për të frikësuar një hajdut të dyshuar, pasi pamjet shqetësuese u publikuan 'online'. Oficerët e policisë në video shfaqen te qeshin, ndërkohë që një hetues hedh gjarpurin mbi një burrë të prangosur që ulërinte nga frika. "BBC" raporton se ngjarja ka ndodhur në rajonin e Papuas në Indonezi. Shefi i policisë lokale tha se ishte joprofesionale, por e mbrojtja si praktikë, duke thënë se gjarpri nuk ishte helmues. Aktivistja e të drejtave të njeriut, Veronica Koman, i publikoi pamjet e rënda në faqen e saj në "Twitter" me pretendimin se autoritetet e kishin vendosur një aktivist që mbështet pavarësinë e Papuas në një qeli me një gjarpër. Në video dëgjohet zëri i dikujt që kërcënon të pandehurin se do t'ia vendosë gjarpurin në gojë dhe poshtë pantallonave. Raportimet për abuzime me të drejtat e njeriut në Papua, ku separatistët prej kohësh kërkojnë pavarësinë në Indonezi janë të shpeshta.

Angli, qeveria kërkon kohë për marrëveshjen për Brexit

Ndërsa afati për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian është pas 47 ditësh, qeveria i kërkoj parlamentit të dielën që t'i japë më shumë kohë kryeministres Theresa May që ta ripunojë marrëveshjen për daljen. Sekretari i Komuniteteve, James Brokenshire tha se parlamenti do ta kishte në dispozicion planin e zonjës May për Brexit, jo më vonë se më 27 shkurt. Premtimi është një përpjekje për të shmangur një debat të ashpër të enjten, kur parlamenti ka në program të debatit dhe të votojë për hapat e mëpasshëm në procesin e Brexit-it. Disa ligjvënës duan të përipiqen të marrin kontrollin dhe të sigurojnë një dalje më të butë nga blloku. Britania pritet të dalë nga Bashkimi Evropian më 29 mars, por parlamenti ka hedhur poshtë projektligjin e zonjës May për shkëputjen, duke detyruar kryeministren të kërkojë ndryshime nga ana e BE-së. Përpjekja e Britanisë për ndryshime të minutës së fundit ka irrituar udhëheqësit e Bashkimit Evropian që këmbëngulin se marrëveshja e detyrueshme për tërheqje nuk mund të ndryshohet.

Një sondë japoneze pritet të ulet në një asteroid

Sonda japoneze "Hayabusa2", tashmë në orbitë, do të përipiqet të ulet në një trup qiellor, njoftoi agjencia hapësinore 'JAXA'. Udhëtimi i ardhshëm parashikohet të transmetohet direkt në internet dhe shkencëtarët gjykojnë se ky do të jetë një mision shumë delikat.

Piloti i pagjetur ende, gruaja: Shpresa nuk duhet humbur asnjëherë

Aksidenti në 21 janar, identifikohet trupi i Sala nga shenjat e gishtave

Del rezultati i autopsisë, ja pse vdiq futbollisti argjentinas

Pas gjetjes së trupit, autopsia ka përcaktuar shkaqet e vdekjes së futbollistit Emiliano Sala. Avioni me të cilin udhëtonte ai u rrëzua në det më 21 Janar. 28-vjeçari humbi jetën nga plagët në kokë dhe në gjoks të shkaktuara nga përplasja e avionit në det. Ai u identifikua përmes shenjave të gishtave, pasi trupi i pajetë u gjet në thellësinë e detit nga një ekip i specializuar kërkimesh. Ndërkohë, po vijojnë edhe hetimet nga autoritetet për shkaqet e rrëzimit të aeroplanit. Këto hetime pritet të zgjasin nga 6 deri në 12 muaj, ndonëse brenda 2 javësh pritet të dalë një raport i përkohshëm paraprak. Në bordin e avionit që u rrëzua ishin vetëm piloti dhe futbollisti. Ky i fundit sapo kishte nënshkruar me ekipin e Kardif dhe ishte nisur nga Franca drejt Uellsit. Aeroplani i vogël tip "Piper Malibu" humbi kontrollin në radio dhe u zhduk nga radarët. Mbetjet e avionit u gjetën javën e kaluar në thellësinë e detit pranë brigjeve franceze. Autoritetet britanike kanë identifikuar trupin e gjetur nën rrënojat e avionit të rrëzuar, ku udhëtonin futbollisti argjentinas, Emiliano Sala dhe piloti David Ibbotson. Sipas 'BBC', në deklaratën e policisë së Dorset lëshuar gjatë mbërmjes thuhet: "Trupi i sjellë në Portland Port të enjten më 7 shkurt 2019 është identifikuar zyrtarisht dhe është i futbollistit Emiliano Sala". Trupi u zbulua pas një kërkimi nënujor në avionin që u zhduk nga radarët më 21 janar të këtij viti. Aeroplani i vogël tip "Piper Malibu" ishte nisur nga Franca dhe do të udhëtonte drejt Uellsit, kur humbi nga radarët dhe u rrëzua në det. Në bord ishin vetëm dy persona, futbollisti 28-vjeçar dhe piloti.



POLICIA:

"Trupi i sjellë në Portland Port të enjten më 7 shkurt 2019-të, është identifikuar zyrtarisht dhe është i futbollistit Emiliano Sala", ka deklaruar policia e Dorset.

së kërkuar për mua, prandaj as unë nuk do të ndaloj së kërkuar për të. Kërkimet janë duke vazhduar dhe ne shpresojmë që së paku të marrin trupin e tij". Kujtojmë se futbollisti Emiliano Sala ishte në bordin e avionit carter që u zhduk nga radarët pranë disa ishujve në Evropë. Lajmi është konfirmuar nga Autoriteti Francez i Aviacionit Civil. Sulmuesi argjentinas i skuadrës së Kardif ishte një nga dy personat që ndodheshin në bord. Policia ka thënë se nuk ka gjetur asnjë gjurmë të avionit të zhdukur. Carter u ngrit në fluturim në orën 19:15 të së hënës nga aeroporti i Nantes në Francë dhe kur ndodhej në 1.5 kilometër lartësi kontakti me kullën e kontrollit të trafikut ajror. Në 700 metra lartësi, aeroplani humbi kontaktet. Gjatë natës nisën kërkimet për gjetjen e avionit, por u pezulluan rreth orës 02:00 për shkak të erës së fortë, përkeqësimit të kushteve të motit dhe uljes së dukshme të humbur, në bordin e të cilin udhëtonte edhe futbollisti i skuadrës angleze Kardif.

"ZEMRA E HAPËSIRËS" MUND TË SHITET DERI NË GJYSMË MILION DOLLARË

Një ankad "kozmit", që do të zgjasë prej datës 6-14 shkurt në festën e Shën Valentinit do të jetë i hapur për shitjen e një meteori në formë zemre, i cili ra në Siberi 72 vjet më parë. Fragmenti, sipas shtëpisë më të madhe të ankandit në botë "Christie's", mund të arrijë një çmim deri në 500 000 dollarë. "Meteoriti është një prej fragmenteve të një asteroidi të pastër hekurit, që peshonte 90 tonë, i cili ra mbi malet e Sikhote-Alin në Siberi 12 shkurt 1947", thotë "Christie's".



FOTOLAJM

kërkimet për trupin e pilotit të aeroplanit, David Ibbotson. Gruaja e pilotit ka thënë se familja nuk i ka humbur shpresat për gjetjen e trupit. Ajo shprehet: "Shpresa nuk duhet humbur asnjëherë. Jam e sigurt se ai nuk do të ndalej

ZBULIMI

Një zbulim sensacional, Da Vinci rishfaq artin e tij të madh

Nga Luan Rama

Epabesueshme... Dora e Leonardo da Vincit na rivjen sërish dhe na shfaqet me një krijim të panjohur: "Martiri San Sabastian"... Duket sikur ka zgjatur dorën sipër varrit për të na treguar dhe një vizatim të thjeshtë të tij. Martiri është atje, lidhur në një pemë të zhveshur, në një peizazh morti, në konvulsionet e tij, gjysmë i zhveshur, me imazhin e martirit që mund të krijonte vetëm një artist si ai. Po, ishte madhështia e penës së tij duke punuar në atelienin e tij në Firenzë, një vizatim i viteve 1478-1483. Një trup i goditur nga ndëshkimi, me kokën lart si të kërkonte ndihmë nga ndonjë hyjni. Linja të hedhura lirshëm, me një frymë, siç ndodhte në etydet e tij për të bërë pastaj tablotë e Monalizës apo Jezusë. Si ndodhi kështu rishfaqja e këtij vizatimi të humbur e të panjohur gjatë pesë shekujve, pas aq e aq kërkimesh të studiuesve të ndryshëm që kërkonin në arkivat e Milanos, Venecias, Vatikanit, Londrës, Parisit apo Berlinit. Kështu, papritur, vizatimi u zgjua nga ajo përgjumje e madhe në dokumentet e një njeriu të zakonshëm, ku një mjek francez, i cili kishte mbledhur vizatime të ndryshme që ruante i ati diku në një dollap, vendosi një ditë t'i çonte në Shtëpinë e Ankandit "Tajan" në Paris, për t'i ekspertizuar dhe shitur. Ai kurrë nuk kishte menduar se mes tyre mund të ishin vizatime të Leonardos, vizatim, i cili menjëherë u shpall "tesor national" ("thesar kombëtar" i Francës) dhe që shtëpia "Tajan" kërkon ta shesë për 15 milionë euro. Edhe pse pa firmë eksperti i kësaj shtëpie botuese e kuptoi menjëherë se kishte të bënte me diçka disa shekullore dhe që i përkiste ndonjë piktori të Rilindjes italiane. Po cili?... Dhe kështu, pas tetë muajsh Patrick de Baysar dhe më pas ekspertja e Metropolitan Museum të Nju Jorkut, Carmen C. Bambach njohës të mirë të veprës së artistit florentina, arritën në konkluzionin se vizatimi ishte i Leonardo da Vincit. Dukej që ishte bërë nga një dorë e mëngjert dhe Leonardo punonte gjithnjë me dorën e majtë. Ekspertët zbuluan se vizatimi i përkiste një flete që i takonte fletoreve të vizatimeve që përbënin atë që quhet "Codex Atlanticus".

E vështroj këtë vizatim dhe menjëherë më shfaqen imazhet e tablove të shkëlqyera të Mantegna-s për martirin San Sebastian (1480), apo e tablosë së Tizanos, tablo këto të mëdha me ngjyra dhe plot kolorit. Por tek Leonardo, qëndrimi i personazhit (figura e tretë

e shenjtë në Romë pas Shën Pjetrit dhe Shën Paul) është krejt tjetër. Një skicë e bërë aty për aty, me penën e tij (penë) me bojë kafe, i ka dhënë figurës së martirit një pamje trallsëse, në çastin kur perandori romak, Diocletian për ta ndëshkuar, me që ai u kërkoj miqve të tij të mos hiqnin dorë nga feja kristiane, urdhëroi ta qëllonin me shigjeta, lidhur pas një trangu. Fytyra e martirit është shumë shprehëse e po kështu dhe trupi, ku padyshim për sa i përket anatomisë, Leonardo mbetet mjeshtri më i madh i të gjitha kohërave. Vizatimi ka përmasat 19,3 x 13 cm... pra një fletë fletoreje, çka disa prej tyre i kemi parë në muzeun e Leonardos në Clos Lucé, në Amboise, ku ai jetoi pjesën e fundit të jetës gjersa vdiq. Martiri San Sebastian është trajtuar shumë dhe nga piktorë të tjerë të Rilindjes italiane apo piktorët spanjollë (El Greco), hollandezë, flamandë, etj. Nga Rilindja italiane më të njohura janë tablotë e Rafaelos, Botticelli, Perugini... Në Francë, kompozitori Debussy, krijoi muzikën e një baleti me temën e këtij martiri.

KODIKËT E DAVINCI-T

Siç dihet, sipas testamentit të tij, pas një inventari të hollësishëm të tablove, vizatimeve, shkrimeve për pikturën, arkitekturën, shpikjet shkencore, esetë filozofike, etj, gjithë dokumentet e mjeshtrit të madh toskanas kaluan në trashëgimi të nxënësit të tij Francesco Meltzi, i cili e ndoqi atë deri në castet e fundit. Shumë shkrime për artin, Meltzi i mboldhi dhe i tërhoqi në shtëpinë e tij në Vapria Adda, pranë Milanos, dhe hartoi atë që u quajt "Tratatto della pitura". Ai donte t'i shiste shënimet dhe vizatimet e Leonardos, por askush nuk i blinte, pasi i shikonin pa ndonjë interes. Më vonë, dokumentet u shpërndanë dhe u shitën nga princat, fisnikët e mëdhenj dhe njerëzit e interesuar për gjeninë e Da Vinci-t. Vizatimi i martirit San Sebastian, në kohën kur trashëgimtarët e Meltzi-t i shitën dorëshkrimet tek skulptori Pompeo Leoni, përfshijë në një nga fletoret, në atë që do të quhej më pas "Kodiku Atlanticus". Por me vonë, siç ndodhi me trashëgiminë e dorëshkrimeve të ndryshme të Leonardos, ato u shpërndanë sa në një oborr mbretëror në tjetrin. Prandaj dhe gjithë fondi i Leonardos me gati 10.000-13.000 vizatime e shënime shkencore e filozofike, u nda në disa kodikë si, "Kodiku i Madridit" një dubël-dorëshkrim me 197 faqe në bibliotekën mbretërore të Spanjës, të cilat u zbuluan më 1965 dhe që kishin vizatime inxhinierike të jashtëzakonshme; "Kodiku Leicester", i kontit Thomas Coke, i blerë më

Një krijim i panjohur si "Martiri San Sabastian"



1717 me 72 faqe; Kodiku i Windsor, në bibliotekën mbretërore të Anglisë në kështjellën Windsorit, etj. Madje të dërguarit e Napoleonit më 1796 morën nga Biblioteka princore (ambrosiane) e Milanos dhe i sollën në Francës. Por pas internimit të Napoleonit në ishullin e Saint Helenës, ato u transferuan përsëri në Milano. Interesi për të u shtua më shumë gjatë shekullit XX, kur disa biblioteka dhe muzeume të Europës dhe të Amerikës filluan t'i blinin për arkivat e tyre. Një nga më të fundit ishte dhe një shitje e Kodikut të Da Vinci-t në vitin 1994, prej 72 faqesh me shkrime e vizatime të viteve 1506-1508, (përfshi këtu vëzhgime mbi masën dhe formën e hënës), kur patroni miliarderi i "Occidental Petroleum", amerikanë 83 vjeçar Armand Hammer kërkonte një shifër astronomike: 23 milionë franga, ndërkohë që Bibla e Guttenberg në New York, më 1978, kishte kushtuar veçse 10 milion. Shkrimet dhe vizatimet e tij të shpërndara nëpër vizatimet e tij të ndryshëm, herë-herë janë të një periudhe apo të një fushe të caktuar dhe herë të tjera janë të përziera. Ndër kodikët e sistemuar nga studiues të Da Vinci-t, kodikët e mjeshtrit janë kualifikuar në: "Codex Arndel", koleksion ky që ruhet në British Library me dokumente që kapin periudhën 1498-1518, me vizatimet për kanalin e Romorantit të Francës dhe pallatin mbretëror; të çka e kishte porositur François I: "Codex Forster" (John Forster), që ndodhet po në Londër, por në Victoria and Albert Museum (më së shumti me dokumente rreth

gjeometrisë, hidraulikë, etj.; "Codex Atlanticus", me 12 volume, i cili gjendet në Bibliotekën "ambrosiane" të Milanos dhe që përfshin skica e shënime për balistikën, astronominë, gjeometrinë, hidraulikën, etj. Ky kodik (Codex) u quajt Atlanticus për formatin e madh që kishte (lidhur me veshje lëkure nga vetë Pompeo Leoni) në dimensionet 64,5x43,4 cm., çka të krijonte atlasat e vjetra. Janë, gjithashtu, "Codex Trivulzianus", i cili gjendet në kështjellën e princave Sforza të Milanos, me shënime e skica rreth arkitekturës, anatomisë, kuajve, gjeometrisë, ku madje ka dhe karikatura; "Codex Ashburnham" i ndarë në dy pjesë, ku njëra ndodhet në Bibliotekën Kombëtare të Francës, BNF dhe tjetra në Bibliotekën e Institutit de France; një kodik mbi fluturimin e zogjve ("Kodiku i zogjve") që ndodhet në Bibliotekën Mbretërore të Torinos, etj. Nga 13.000 vizatime që kishte trashëguar nipi i tij Meltzi, sot ekzistojnë veçse 7.000, pra afërsisht gjysma kanë humbur. Sidoqoftë, para se të vdiste, krahas vëzhgimeve të tij për madhësinë dhe formën e hënës, Leonardo shkroi dhe një vëllim të fundit me mendimet e tij për pikturën. Mesa duket aventura e Da Vinci-t nuk ka mbaruar. "Prushet" e fjetura të mjeshtrit rëzohen dhe na shfaqin madhështinë e një arti të jashtëzakonshëm. Vallë si do të ishte ky vizatim po të ishte kthyer në një tablo me ngjyra të dimensioneve të mëdha, siç pikturonte Leonardo. Padyshim do të kishte qenë shumë më e bukur se ajo e Tiziano-s dhe e Montegna-s, pasi Leonardo ka bërë një zgjidhje tjetër për figurën e tij. Martiri i tij nuk qëndron në formë ballore dhe pa përpëliten e një martiri, por ndryshe nga ta, përmes tij, në ndëjmë të vërtetë martizimin e heroit të Da Vinci-t përballë egërsisë së një perandorë. Sidoqoftë, Franca ka vetëm 30 muaj afat për ta mbajtur brenda territorit të saj këtë vizatim nëse ndonjë nga institucionet e saj dhe së pari Musée du Louvre apo Musée d'Orsay do ta blinin për 15 milionë euro. Në mos, jo pak institucione amerikane, kineze, japoneze, etj. apo biznesmenë të mëdhenj, do ta blejnë dhe ky vizatim do t'i mungojë Francës... Po, Leonardo është në ankand... e megjithatë, zbulimi i rastësishëm i këtij vizatimi është padyshim një ngjarje në fondin e trashëgimisë botërore. Ardha në Francë pranë mbretit François I-rë, i ndali hovet krijuese piktorale të Leonardos, por ndërkohë bëri të zhvillohej një trashëgimi tjetër: ajo e vizatimeve, shpikjeve të jashtëzakonshme, studimeve shkencore dhe zbulimit të anatomisë njerëzore, për çka Leonardo i ri kishte punuar vite me radhë. Më 18 shkurt kam shansin që ta shoh nga afër këtë vizatim që do të ekspozohet nga "Shtëpia Tajan" në zemër të Parisit.



SIMPOZIUMI

"Gjirokastra lexon Musinenë"

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Muzeun "Musine Kokalari" dhe Wikimedians of Albanian Language UG organizojnë aktivitetin sot "Gjirokastra lexon Musinenë" në Gjirokastrë.

Figura shumëdimensionale e Musine Kokalarit, veprimtars politike e kulturore dhe shkrimtars me vizion, përkujtohet në një simpozium të posaçëm në qytetin e saj. Paralelisht me simpoziumin, një grup të rinjsh dhe ekspertët përkatës punojnë për pasurimin dhe saktësimin e materialit zyrtar për të, në punëtorinë edit-a-thon "Musine Kokalari në Wikipedian shqip". Janë ftuar të jenë pjesë e takimit qytetarë të interesuar, të rinj e studentë, përfaqësues të institucioneve publike dhe joqeveritare, shoqatave për të drejtat e njeriut dhe të përndjekurve politikë, artit, kulturës dhe medias.

Simpoziumi hapet nga Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Me kërkesë të familjes, dosja e parë që Autoriteti hapi para dy vjetësh, në nisje të punës së tij, ishte ajo e Musine Kokalarit, e dënuar, survejuar dhe përndjekur për vite me radhë. Zamira Rami, Kryetare e Bashkisë Gjirokastrë mban fjalën e saj, e pasuar nga studiuesja Fiona Todhri, e cila i ka trajtuar gjerësisht dhe me profesionalizëm figurat e grave të dënuara politike gjatë regjimit komunist, mes të cilave, Musine Kokalari, gra që hodhën themelet dhe tentuan krijimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Një ndër kontribueset kryesore të kësaj veprim-



tarie, Arjeta Kokalari, Drejtore e Muzeut "Musine Kokalari" flet mbi sfidat e trajtimit të trashëgimisë së saj në ditët e sotme. Në emër të Shoqatës Antikomuniste të ish-të Përndjekurve Politikë, Nebil Çika shprehet mbi mekanizmat e përndjekjes së zonjës Kokalari dhe vlerat njerëzore me të cilat ajo u përball me strukturën shtetërore.

Krijimtaria e pasur letrare e Musine Kokalarit trajtohet dhe diskutohet nga studentët të Universitetit "Eqrem Çabej", të cilët e plotësojnë figurën e saj me aspektin artistik. Kësisoj, simpoziumi krijon një kuadër të plotë të figurës së Musine Kokalarit, nga vlerësimi i vetëdijes intelektuale, integritetit dhe fryma idealiste që karakterizonte një grua të tillë, të qëndrueshmëria, dinjiteti njerëzor dhe përfaqësimi i lartë i vetvetes, ideve e prirjeve të saj, ditët e gjykitimit e më pas.

Paralelisht zhvillimit të simpoziumit, në një mjedis tjetër organizohet punëtorja edit-a-thon

Përkujtohet figura shumëdimensionale e Musine Kokalarit

"Musine Kokalari në Wikipedian shqip" dhe maratona e editimeve në Wikipedian në gjuhën shqipe për Musine Kokalarin, duke synuar një produkt konkret, serioz dhe të mirëmenduar për një nga personalitetet mbresëlënëse të jetës politike, kulturore, artistike e shoqërore shqiptare. Në fund të takimit, të pranishmit zhvillojnë një vizitë në shtëpinë e Musine Kokalarit artistik. Kësisoj, simpoziumi në përfundim të punëtorisë do të ketë vizitë në shtëpinë e Musine Kokalarit dhe vizitë në burgun e Gjirokastrës.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to, bazuar në ligjin nr.

45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Autoriteti e mbështet punën e vet dhe vijësinë e projekteve të ndërmarra në parimet e rëndësishme të kujtesës, që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe mbështetjen e identiteteve dhe bashkësive, si paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; evitimi i shprehjeve deterministe; shmangia e përgjithësimeve; trajtimi i figurave historike si individë; sigurimi i një baze gjeneine historike; përdorimi i njohurive të

“
Krijimtaria e pasur letrare e Musine Kokalarit trajtohet dhe diskutohet nga studentët të Universitetit "Eqrem Çabej", të cilët e plotësojnë figurën e saj me aspektin artistik. Kësisoj, simpoziumi krijon një kuadër të plotë të figurës së Musine Kokalarit

nivelit akademik si burime, ku çdo përmbajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe certifikuar për njohuritë specifike e të duhura.

Mbështetur në këto parime, në kërkimin shkencor dhe përballjen profesionale të fakteve, Autoriteti vijon të ndërmarrë projekte ambicioze e komplekse, që kanë në fokus rishqyrtimin e historisë, rivlerësimin e saj, rehabilitimin e viktimitave, rezistencën në personalitete e komunitete dhe inkurajojnë dialogun social, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë.

CODHAPEKSPOZITËN

FOTOGRAFIKE "BALKAN GIRL POWER"

COD hap ekspozitën fotografike "Balkan Girl Power" kuruar nga artistja britanike, Lala Meredith Vula. 75 vajza, të grup-moshave nga 18-26 vjeç nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, janë bërë bashkë në këtë projekt, i cili nisi si një platformë online në muajin korrik të 2018. Ato patën mundësi të trajnohen, këshillohen nga mentoret: Blerta Kambo, Fjolla Besimi, Maja ?uri?, Marija Djokovic, Tamara Zidar, Tomislav Georgiev për të menduar në mënyrë kritike e krijuese, mbi realizimi e fotografive që bartin mesazhe të forta. Ekspozita synon që përmes fotografive e çdo imazhi, të shpalsë rrugëtimin jo të lehtë të gruas në këto vende dhe problemet me të cilat ajo përballlet çdo ditë. Përmes Balkan Girl Power, vajzat pjesëmarrëse nga pesë vende e Ballkanit Perëndimor; dokumentojnë jetën, ëndrrat dhe perspektivat që gjithseci-

la ka në raport me veten, vendin, rajonin dhe sfidat e së ardhmes për t'u bërë pjesë e integruar në Bashkimin Europian. Më 12 shkurt në orën 11:00, një ditë pas ceremonisë së hapjes së ekspozitës, në Forumin e COD do organizohet një workshop mbi temën "Të genit një vajzë në Ballkanin Perëndimor" dhe një master klasë nga Lala Meredith Vula, profesoreshë e artit dhe e fotografisë në Universitetin "De Montfort", në Britani. Ekspozita përmban 68 fotografi të përzgjedhura e do të qëndrojë e hapur për publikun, deri më 28 shkurt 2019. * * * Balkan Girl Power, është një iniciative rajonale e mbështetur nga Western Balkan Fund. Instituti për Kontratën Shoqërore në Shqipëri zbatoi dhe udhëhoqi këtë projekt në bashkëpunim me katër organizata partnere të shoqërisë civile, si: Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis në Kosovë, Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë, iACT në Mal të Zi, dhe Shoqata për Promovimin e Aktivizimit, në Serbi.

PREZANTOHET PLLAKATI I PULLËS POSTARE PËR SKËNDERBEUN NË FRANCË

Plakati për prezantimin e pullës së postës me figurën e "Gjergj Kastrioti SKËNDERBEU" emetuar nga "La Poste, FRANCE". Plakati është propozuar prej La Maison de l'Albanie me zgjidhje grafike të Zamir Matit mbështetur në idenë projekt të skulpturës në siluetë të prerë me lazer të luftërarëve të Skënderbeut "Drejtë Europës", ide projekt i propozuar për sheshin Skanderbeg, Paris. Vlera monetare e pullës postare është për shërbimin e shpejtë brenda Francës dhe për peshën e letrës deri në 20g. Pulla e postës SKANDERBEG e La Poste FRANCE është në bilok me 10 pulla dhe në fletë me 30 pulla. Në takimin e datës 12



shkurt 2019 do të ekspozohen biloku filatelik me pullën e postës "SKANDERBEG" dhe pulla sho-

qëruese e saj "KRUJA", kartolina dhe zarfë me pullën në ditën e parë të qarkullimit të

Intervista
e Ditës

A ka gjasa për një marrëveshje Kosovë-Serbi?

Nga Bekim Shehu

(vijon nga faqja 1)

... dhe pse nuk ka një unifikim ndërkombëtar për këtë marrëveshje.

DW: Z. Rashiti, ka një debat gjithandej si në arenën ndërkombëtare, edhe atë lokale rreth çështjes së Kosovës në raport me Serbinë. Ka qëndrime nga më të ndryshmet për dialogun dhe rrjedhën që duhet të ketë, por hapa konkrete ende nuk ka. Si i shihni ju këto zhvillime?

Naim Rashiti: Dialogu dhe konsultat janë duke u zhvilluar dhe një farë forme draftimi, apo konsultimi i një marrëveshjeje të mundshme është duke u zhvilluar. Takimet formale nuk janë duke u mbajtur, por ka një presion në rritje, që takimet formale të fillojnë gjatë këtij muaji, apo më së largu deri në prill apo maj. SHBA-të dhe BE-ja janë dakorduar për fillimin e takimeve formale, por Serbia po e kushtëzon fillimin e këtyre takimeve me heqjen e taksës së vënë nga qeveria e Kosovës për prodhimet serbe. Sesa do të vazhdojë kjo situatë, nuk dihet, por nuk shoh që do të ketë heqje të taksës nga Prishtina. Mirëpo, tani për tani është shumë e vështirë të dihet se çfarë po ndodh me dialogun.

E përmendet një marrëveshje, që siç thoni është duke u draftuar apo konsultuar, por pa takime formale. Si e shini ju këtë marrëveshje?

Është shumë e vështirë për ta parashikuar se çka është ajo marrëveshje. Por, ajo që dihet është se kabineti i shefes së diplomacisë evropiane dhe SHBA-të janë duke punuar intensivisht me dy presidentët Thaçi dhe Vuçiç për t'i përafuruar qëndrimet, por pak dihet në publik dhe sa më pak që po dihet në publik, gjasat për një marrëveshje po minohen.

Kush po i minon gjasat, jotransparenca, mosunifikimi i klasës politike kosovare, qëndrimi i ngurtë i Serbisë, Kosovës, apo çfarë?

Janë tre faktorë. I pari është sesi



bëhet një marrëveshje për ta siguruar njohjen e Kosovës nga Serbia, pra a është e gatshme Serbia të shkojë deri në fund me njohje dhe a do ta pranojë këtë marrëveshje dhe të gjithë ata që janë në dialog dyshojnë në këtë se a do ta përmbyllë Serbia marrëveshjen. Faktori i dytë është faktori ndërkombëtar, ku ka dallime të mëdha dhe për shkak të këtyre dallimeve të mëdha po punohet në një qark shumë më të vogël. Dhe faktori i tretë është faktori kosovar, që ka dallime shumë të mëdha sa i përket një marrëveshjeje finale sesi do të duket ajo. Pra janë tri segmente, përveç të parës, dy të tjerat nuk kanë ndodh më herët as në procesin e Vjenës apo diku tjetër.

Z. Rashiti, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit për Kosovën ishte ambasadori gjerman në këtë organizatë, që

shprehu qëndrimin kundër ndryshimit të kufijve Kosovë-Serbi dhe tha se anëtarësimi i Serbisë në BE kalon vetëm përmes një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse ligjërisht të detyrueshme? Ky qëndrim i Gjermanisë, i përsëritur nga kryeministri Haradinaj, që deri në një masë nuk po mbështetet nga presidenti Thaçi për qasjen e tij ndaj dialogut. Ka shpresë për një unifikim qëndrimi edhe në Kosovë, edhe në arenën ndërkombëtare rreth çështjes së Kosovës?

Nuk e besoj se do të ketë unifikim qëndrimi të faktorit ndërkombëtar. Ajo që po ndodh te faktori ndërkombëtar dhe ai lokal është se nuk po besojnë se do të ketë një marrëveshje, edhe me modifikim kufijsh, edhe me njohje dhe me një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërmjet dy vendeve. Ajo

çfarë po ndodh me Gjermaninë është se duke mos besuar se mund të arrihet një marrëveshje, ata vetëm kanë filluar të mendojnë sesi do të dukej dialogu nën një udhëheqje të re të BE-së që pritet këtë vit. Në Kosovë dallimet mes liderëve rreth zgjidhjes finale nuk besoj se do të veniten shpejt. Nuk besoj se do të ketë mbështetje për një lider apo tjetrin për shkak të pozicioneve. Pra, edhe SHBA-të kërkojnë që ky proces të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të ketë legjitimitetin demokratik, sepse në këtë situatë nuk mund ta kalojë.

Z. Rashiti ka një percepton të brendshme në Kosovë që i gjithë presioni për bilokimin e dialogut po bie mbi palën kosovar dhe jo mbi Serbinë. Sa me vend mund të jetë ky konstatim?

Perceptoni tash për tash është që Kosova po dështon të jetë e për-

gatitur për një proces dialogu. Asnjëherë në historinë e Kosovës nuk është akuzuar Kosova se po e dështon procesin e dialogut. Por, në Bruksel, në Berlin në Vjenë e SHBA, tamë po flitet se si liderët e Kosovës nuk po e mbështesin dialogun, sepse të gjitha përpjekjet ndërkombëtare janë për një proces më intensiv, ndërsa mbetet krejt në fund të shihet a ka marrëveshje apo jo. Nga ana tjetër pas këtyre zhvillimeve në Kosovë, presidenti serb, Vuçiç, po thotë se ai është gati për marrëveshje, por janë shqiptarët që nuk janë gati dhe ai e ka bindur faktorin ndërkombëtar me këtë. Pra, mendoj se do të ketë një kosto ndërkombëtare për pozicionin e Kosovës, jo kosto për shkak të kërkesave për kompromise, por për shkak të mosgatishmërisë për të vepruar si një shtet që merr vendime në raport me dialogun.

Por, në realitet Serbia a mendon se është e gatshme për marrëveshje me Kosovën?

Unë dyshoj shumë. Serbia mund të jetë e gatshme për një marrëveshje krejt radikale, nuk e besoj që Serbia është e gatshme për një marrëveshje në kuadër të kufijve të Kosovës. Ndoshta do të pranonte një lloj Brukseli 2, një lloj ringocimi të marrëveshjeve, me një lloj autonomie për veriun, duke mos ofruar edhe njohjen e Kosovës në mënyrë implicite. Ndoshta Serbia do të ofronte marrëveshje me ndarje të Kosovës, në mënyrë që ta njohë Kosovën, por ajo do të jetë tepër e vështirë për t'u pranuar në Kosovë dhe nuk e besoj që do të ketë kurajë politike dikush në Kosovë që ta pranojë me një shkëputje të njëanshme të territorit. Dhe e fundit është që problem në Serbi përveç zhvillimeve të brendshme është Rusia, ndaj së cilës Serbia dhe presidenti serb nuk po dinë si të sillen. Kam përshtypjen që ka pasur përpjekje të vazhdueshme nga Serbia për të marrë miratimin e Rusisë për një marrëveshje me Kosovën dhe për këtë janë në panik dhe është shumë e paqartë se çfarë do të bëjë Rusia me Serbinë deri në finale të dialogut me Kosovën.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

Kultura e dhunës fshihet pas perdes së patriarkatit

Nga Izela Tahsini

(vijon nga faqja 1)

... re dukshëm në të folurin rreth saj, në media dhe shoqërisht, me reagime vajtuese (ububu, e tmerrshme), fajtor-kërkuese (po nëna si nuk e kuptoi?...), apo mohuese (mos ma hap fare këtë temë/dua të qaj në emision), etj. Shumë biseda e talk-show rrotulloheshin e i riktheheshin pyetjes: Si ka mundësi? Nganjëherë dukej sikur dëshironin ta kthenin ngjarjen në një përjashtim, si një anomali, që duke qenë e tillë nuk përsëritet më.


Kjo dëshirë për zhbërje, një mekanizëm mbrojtës i mirënjohur për shoqërinë tonë, në fakt, është nga çështjet e para të nevojshme për t'u adresuar, që mundësia për ngjarje të tilla të minimizohet në të ardhmen. Qëndrimet fataliste të llojit kjo shoqëri jemi/edhe në botë ndodhin gjëra të tilla/prapë do të ndodhin, nuk i hyjnë në punë kujt. Pra, duhet të flasim. Duket sikur media e ndihmon këtë të folur përmes emisioneve të pafundme të këtyre ditëve, por pas kësaj vijne pyetjet: si jemi duke folur për këtë që ndodhi? Cili është diskursi dominant? A ka një mënyrë të re, më ndihmuese e jofataliste për ta bërë këtë?

Së pari, dua të theksoj se të trajtuarit e ngjarjeve si 'scoop', të ngecurit tek ngjarja si kuriozitet, e të mos zhvendosurit tek të folurit për fenomenin, e për më tepër rrjedhja e vazhdueshme e të dhënave identifikuese për rastet në emisione, ndonjëherë dhe nga profesionistët, nuk është vetëm joetike, por e pafalshme. Në lidhje me ngjarjen në fjalë, Këshilli Shqiptar i Medias publikoi një deklaratë ku i tërhoqi veshin gazetarëve për një sërë shkeljeshe etike. Gjithsesi, nëse nuk do të ketë asnjëherë penalisht në këtë drejtim, nuk mund të ketë ndryshim.

Megjithatë, përtej trajtimit mediatic të ngjarjes, besoj se ka ardhur koha që të pranojmë plotësisht dy të vërteta të rëndësishme: jetojmë në një shoqëri patriarkale dhe reagimi institucional është i pamjaftueshëm.

Të pranosh se jeton në një shoqëri patriarkale, nuk do të thotë të dorëzohesh, por, së pari, të kuptosh si ndikon kjo në prodhimin e ngjarjeve të tilla, dhe më tej të flasësh sesi dillet prej kësaj. Tashmë, me gjithë variacionet, ka një marrëveshje të përbashkët, jo vetëm në literaturën përkatëse, por edhe në të folurin publik dhe shoqëror në Europë e më gjerë, rreth të kuptuarit të patriarkatit si një shoqëri e dominimit maskullor dhe shpërndarjes së pabarabartë të pushtetit mes burrave e djemve, përkundrejt grave e vajzave, duke rezultuar në norma shoqërore dhe praktika shtypëse.

Në një shoqëri të tillë, një vajzë



në përballje me fillimet e seksualitetit të saj, mund të mos t'i drejtohet asnjëherë prindërve për informim e mbështetje, për të cilat mund të ketë aq nevojë, për të ditur se trupi i saj është i saj, se ajo do ta ndajë me atë që dëshiron, vetëm kur dëshiron e është gati, e jo prej presionit të të dashurit apo të moshatarëve, apo aq më shumë, jo prej shantazhit. Biseda të tilla mund të mos të bëhen as në klasë. Rrjedhimisht, aq më pak kjo vajzë nuk do të drejtohet për ndihmë, kur është në telashe, nëse shoqëria e konsideron seksualitetin femëror, veçanërisht në këtë moshë, tabu. Ajo trembet se në vend të mbështetjes, telasheet do të shumëfishohen. Kjo është një ndër arsye kryesore që shumë gra e vajza sjellin për herë të parë në terapi, pas dekadash, histori të abuzimit seksual të hershëm. Po t'ia thosha familjes/të rriturve do të bëhej më keq, jo më mirë.

Në një shoqëri patriarkale, të folurit me djemtë rreth marrëdhënieve me vajzat, nuk është pjesë e zakonshme e bisedave familjare. Një baba dhe nënë mund të mos të ulen me të birin për të folur herë pas here, sesi duhet ta trajtosh një shoqe me respekt, sesi nuk mund ta prekësh asnjëherë pa

dëshirën e saj, as 'me shaka'; sesi 'jo do të thotë jo' dhe nuk duhet të shtysh më tej, sesi të gjitha këto nuk janë opsionale, po të palejueshme. Biseda të tilla mund të mos të bëhen as në klasë. Po kështu, edhe një djalë që mendon ndryshe, në këtë shoqëri, nuk do të flasë kur shokët e tij po tallen në një grupë seksuale me një nga vajzat e klasës apo në rrugë. Në një shoqëri patriarkale, përfitojnë privilegje si burrat edhe gratë patriarkale, dhe këta e kanë shumë të vështirë apo nuk duan ta shohin realitetin me këto syze. Po kështu, në këtë shoqëri, nga këto biseda të pabëra vuajnë vajzat e gratë, por edhe burrat e djemtë. Këto janë çështjet për të cilat kemi nevojë të flasim dhe gjua që kemi nevojë të ndërtojmë, për të krijuar një realitet të ri, në shtëpi, me fëmijët, në kafe, me miqtë dhe kolegët, në media e kudo.

Krahas një guhe të re, patjetër që ka nevojë për ndërhyrje të reja. Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, me gjithë përpjekjet e punës e vazhdueshme të shumëpunonjësve individualë, organizativë, por dhe disa institucioneve të përkushtuara, mbetet ende në nivelin e ndërhyrjeve terciare, kur ngjarja tashmë ka ndodhur. Për më

tepër, edhe në këtë nivel, për shumë nga arsytet e lartpërmendura e të tjera, identifikimi dhe raportimi i rasteve në kohë çalon. Nga ana tjetër, ndërhyrjet parandaluese (para se ngjarja të ketë ndodhur), mbeten shpesh pjesa 'teorike' e çdo dokumenti. Janë të nevojshme aktivitetet e vazhdueshme ndërgjegjësuese në klasë, në komunitet, në media, në çdo hapësirë publike, mbi të drejtat e vajzave dhe grave, abuzimin seksual në rrethin e besimit, mbrojtjen e fëmijëve, detyrimet ligjore të institucioneve, mbi patriarkatin, etj. Këto ndërhyrje i drejtohen si popullatës së gjerë, ashtu dhe fokusohen tek grupe të caktuara, si baballarët, nënat, mësuesit, etj.

Studimet e politikave nuk mungojnë, e në veçanti relevante janë një studim i vitit 2015 mbi abuzimin seksual në rrethin e besimit dhe një dokument politikash bazuar mbi të. Gjithashtu, praktikant e mira në këtë fushë nuk mungojnë në vendet rreth nesh, por zbatimi i tyre në vend kërkon planifikim të mbështetur nga një buxhet ekzistent, si në nivel qendror, ashtu dhe vendor. Vajzat dhe djemtë nuk mund të presin dhe koha është tani.

Reporter.al

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje mund të provojnë gjëra të reja sot. Është e rëndësishme se nëse keni vendosur të eksperimentoni, të mos e vini në dyshim suksesin. Kjo e martë nuk është dita e duhur për të krijuar marrëdhënie të ngushtë me dikë.

DEMI

Disa Demë do ta kalojnë të martën me optimizëm fals. Mund të bëheni pre e shpresës së kotë për sukses dhe ëndrrat tuaja nuk do të përbushen. Merreni në konsideratë këtë paralajmërim dhe qëndroni me këmbë në tokë.

BINJAKET

Binjakët këshillohen ta kalojnë ditën në paqe. Shmangni entuziazmin e tepërt në biznes dhe mos merrni në përgjegjësi detyrën e dikujt tjetër, pasi kjo mund t'ju shkaktojë stres. Mund të luftoni paksa me emocionet tuaja.

GAFORJA

Gaforret duhet të ulin nivelin e aktivitetit. Ka gjasa që gjatë kësaj dite t'ju vihen në rrezik ato që keni arritur me shumë mundim. Mbajeni në mendje këtë këshillë dhe shpenzoni energjinë duke u fokusuar tek detajet. Në mbrëmje mund të merrni një dhuratë nga të afërmit tuaj.

LUANI

Disa Luanë do ta kalojnë ditën duke u kënaqur dhe duke qenë në harmoni me të gjitha sferat e jetës. Rrethanat do të jenë të përshtatshme për të arritur sukses në biznes. Mos bëni eksperimente me marrëdhëniet në dashuri.

VIRGJERESHA

Virgjëreshat do të përballen me një sërë problemesh sot. Këto probleme janë të lidhura me çështje të vogla në punë dhe në jetë. Ka shans që ti zgjidhni shpejt këto probleme nëse nuk shpërqendroheni nga fjalët e të tjerëve.

PESHORJA

Sot do të jeni të mbrojtur nga dikush, i cili nuk do ta nxjerrë këtë në pah para jush. Avizoj do t'ju mbrojt nga agresioni i disa personave të panjohur dhe do të ndihni të sigurt përballë disa problemeve dhe ngacmimeve. Shprehini shqetësimet tuaja, pasi kjo do t'ju ndihmojë shumë edhe psikologjikisht.

AKREPI

Disa Akrepë do të ndihen shumë të lodhur sot dhe nuk do të kenë dëshirë të kryejnë aktivitetet të ndryshme. Do të ishte mirë që të gjenit mundësi për t'u relaksuar. Megjithatë edhe nëse do të gjeni pak kohë për veten tuaj do të shpërqendroheni nga disa probleme brenda familjes.

SHIGJETARI

Do të ndihni të irrituar gjatë ditës së sotme, madje në disa momente do të reagoni me agresivitet. Megjithatë, kjo mund t'ju ndihmojë në konkurrimit e rivalëve tuaj. Shmangni metodat e padrejta dhe mos manipuloni të tjerët.

BRICJAPI

Bricjapët do të mund të shënojnë sukses në biznes. Duhet të nisni të zbatoni planet që keni bërë për të arritur qëllimet tuaja në të ardhmen. Bëni kujdes me emocionet. Për beqarët e kësaj shenje, vazhdoni të luftoni për të gjetur gjurmë tuaj më të mirë.

UJORI

Për shumë Ujorë, 12 shkurti do të jetë një ditë e mbushur plot punë dhe me shqetësim në familje. Shihini punët me pozitivitet në mënyrë që të ecni përpara. Në mbrëmje rekomandohet që të relaksoheni dhe të shijoni shoqërinë e miqve tuaj të ngushtë.

PESHQIT

Peshqit nuk duhet t'i harrojnë disa gjëra të vogla që i sjellin rehati. Duhet të merrni një vendim të rëndësishëm për të forcur marrëdhëniet tuaja personale. Pra, nëse jeni të martuar, mos e vononi zhvillimin e një bisede të nevojshme.

DREJTORI I LACIOS



Skuadrat dhe trajnerët ga
Srojnë dhe bëjnë çmos për
të arritur vende sa më të
mira në renditje për objekti-
va të rëndësishëm, ndërsa
drejtorët nuk qëndrojnë as-
një ditë të qetë dhe shikojnë
për përforsime ideale, që në
verë t'u japin trajnerëve,
ekipe sa më të kompletuara.
Drejtori Sportiv i Lacios, Igli
Tare, është vënë në gjurmët
e talentit të Lanusit, De La

Igli Tare "djeg" Juventusin dhe Interin për talentin argjentinas

Vega, lojtar për të cilin janë
shumë të interesuar dhe
Juventusi e Milani, por ish-
lojtari i Kombëtares kuqezi
duket se ka "djegur" në kohë
dy gjigantët italianë. De La
Vega është një lojtar mjaft i
ngjashëm me Felipe Ander-
sonin, teksa raportohet se
zyrtarizimi i marrëveshjes

mes kryeqytetasve bard-
hekaltër dhe Lanusit është
është ditësh. Gjithash-
tu, Tare po vëzhgon me
shumë interes edhe
mbrojtësin e djathtë të
Strasburgut, Keni Lalan,
për të cilin klubi francez
kërkon minimalisht 10 mil-
ionë euro për ta lënë të lirë.

KOMBËTARJA



Turqia shkarkon Luçeskun para ndeshjes me Shqipërinë

Mircea Luçesku nuk është më trajner i përfaqësueses së Turqisë, lajm i cili është bërë zyrtar nga të dyja palët. Tekniku i famshëm rumun mori drejtimin e Turqisë në gusht të vitit 2017, ku në 17 ndeshje siguroi 4 fitore, 6 barazime dhe 7 humbje, një ecuri e cila detyroi palët të shkonin drejt "divorcit". "Pas një takimi të zhvilluar sot (dje) mes bordin drejtues të federatës dhe trajnerit Mircea Luçesku, u vendos ndërprerja e marrëveshjes me mirëkuptim mes palëve, lexohet në njoftimin e Federatës Turke. "Mendoj se kam përfunduar punën për të rinuar ekipin e Turqisë dhe kemi arritur në destinacionin e kërkuar. Ndaj, para fillimit të eliminatoreve vendosëm bashkërisht që t'i hap rrugën trajnerit të ri", u shpreh trajneri për mediat turke. Vendi në stolin e Turqisë pritet ta marrë Shenol Gynesh, trajneri aktual i ekipit të Besiktash. Ky shkarkim i Luçeskut vjen përpara fillimit të fazës kualifikuese në "Euro 2020", ku Turqia do të luajë takimin e parë kundër Shqipërisë në "Loro Boriç" më 22 mars.



Jeton Selimi

Korçarët ngjiten në vendin e katërt me 33 pikë, 3 më pak se Teuta e vendit të tretë

Skënderbeu fiton pas 3 muajsh, lë pas krizën dhe kalon Laçin

Krasniqi e Pervan e bëjnë të pavlefshëm golin e Selmanit

Skënderbeu i ka dhënë fund 'thatësirës' prej 6 humbjeve radhazi dhe ka gjetur më në fund fitoren në javën e 21-të të kampionatit. Skuadra kampione në fuqi ka thyer ekipin e Laçit me rezultatin 2-1, ndërsa të gjithë golat e sfidës u shënuan në pjesën e dytë. Në një atmosferë të vakët dhe në prezencë të një numri të vogël tifozësh, skuadrat kanë nisur sfidën të kësaj jave. Në të vërtetë goli mund të kishte ardhur që në fraksionin e parë, por në minutën e 24-ët Dajsnani ndali gjuajtjen e Gjonit, ndërsa 6 minuta më pas kroatit Pervan u ndal vetëm nga shtylla e Selmanit. Në fraksionin e dytë, bardhekuqtë e zhbllokojnë shpejt sfidën, kur në minutën e 56-të, Muzaka do të gjejë mjaft mirë në zonë Krasniqin, i cili me kokë do të realizojë një gol mjaft të bukur. Laçi do të kërkojë barazimin, por goli i Gjonit në të 60-ën do të anulohet për pozicion jashtë loje. Skënderbeu do të gjejë golin e sigurisë në minutën e 77-të, kur Pervan do të shndërron në gol penalltinë e fituar nga Krasniqi. Laçi nuk do të dorëzohet, madje do të shkurtojë diferencat në të 89-ën pas një tjetër 11-metërshi të akor-



duar nga kryesori Koçi. Kësaj radhe ekzekuton portierin kurbinas, Gentian Selmani, që ndëshkon kolegun e tij korçar, Dajsnani. Gjithsesi, nuk do të ketë më kohë për Laçin, që regjistron humbjen e dytë

radhazi dhe mbetet në kuotën e 31 pikëve, ndërsa Skënderbeu rigjen fitoren pas 3 muajsh dhe parakalon pikërisht kurbinasin në renditje, me korçarët që tashmë janë të katërtit me 33 pikë, tri më pak se Teuta e

vendit të tretë. Kështu, Skënderbeu mund të lërë tashmë pas shpine periudhën e keqe që kaloi në këtë sezon dhe të fillojë ringritjen për të synuar pozicionet e para të renditjes.

SUPERLIGA		
JAVA E 21-të		
TE SHTUNEN		
Partizani - Kastrioti		2-0
TE DIELEN		
Kukësi - Tirana		0-1
Luftëtari - Flamurtari		0-0
Teuta - Kamza		0-0
TE HENEN		
Skënderbeu - Laçi		2-1
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	21	46
Kukësi 21	38	
Teuta	21	36
Skënderbeu	21	33
Laçi	21	31
Flamurtari	21	30
Tirana	21	24
Luftëtari 21	21	
Kastrioti	21	16
Kamza	21	16

Besnik Prenga nuk është aspak i lumtur me humbjen që Laçi i tij pësoi në Korçë, mbi të gjitha sepse kjo ishte humbja e dytë radhazi. Por, ajo që e ka mëzitur më shumë trajnerin mirditor është fakti se ekipi i tij ka luajtur pa dëshirë dhe pa gjak.

Pse kaq shumë vuajtje në sulm?

Nuk them që kemi gabuar në merkato, u bënë dy blerje sa për të thënë që u bënë. Kemi shumë probleme në sulm. Urime Skënderbeut, na treguan se si luftohet për ngjyrat e fanelës. Sot (dje) ishim shumë dobët, gabimet erdhën nga mesfusha. Mua më shqetëson shumë ecuria e ekipit. Sot jam shumë i shqetësuar, ne nuk kishim

Trajneri i Laçit akuzon të tijtë

Prenga: Luajtën pa dëshirë dhe pa gjak



dëshirë, ishim pa gjak, na mësuani si luhet futbolli. Ishin ata që treguan se donin fitoren. Në dy ndeshje s'kemi treguar as-

gjë. Që nesër t'i futemi stërvitjes.

Mendon si objektivi Europës është i arritshëm?

Skuadrat treguan që janë aty-aty. Ne nisëm ndeshjen mirë, por më vonë nuk bëmë mirë. Ecuria e ekipit ka qenë e tillë. Ndërrimi i trajnerit nuk sjell asgjë. Diku kemi gabuam në seleksionin.

Janë lojtarët që nuk funksionojnë?

Çdo lojtar ka atë CV e vet. Lojtarët me ngjyrë kanë shumë probleme, sa të marrin

vizat, janë pa stërvitur. Nuk mundemi të fusim këta lojtarë. Këtu është problemi, s'kemi kaq shumë lojtarë të fusim në lojë dhe përshatemi me këta.

Pse i ka humbur kjo grinta Laçi, çfarë nuk shkoj?


Unë nuk jam trajner që bëj shumë zëvendësime. Unë e mbyll ndeshjen me 11 ose me 12 lojtarë. Jam pak kurnac tek kjo pjesë. Kam pasur shumë probleme në sulm. Këtë skemën 4-4-2, jemi të vetmit që po e bëjmë, pasi kam qenë i detyruar nga mungesat. Unë kam nevojë dhe për lojtarët me ngjyrë (më falni për shprehjen). Te mua është e vështirë të marrësh minuta, ai lojtar që më fiton besimin me atë punoi deri në fund.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

Shehi: Tani ta lëmë krizën pas shpine

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi, kësaj radhe kishte se çfarë të thoshte për mediat. Në prononcimin e tij për "Supersport" pas fitores me Laçin, deklaroi: "Jemi të kënaqur sepse u rikthyem te fitoria. Kishim harruar shijen e fitores. Më vjen mirë për këtë, pasi na shërben për besimin dhe vazhdimësinë, pasi kemi një skuadër të re. Prurjet e reja po shkrihen me ekipin dhe më vjen mirë për fitoren sot (dje) që e marrim me lojë. Marko Pervan është një lojtar me shumë cilësi. Ai dhe Sibo erdhën në fund. Duke parë cilësitë e tij, e futëm që në ndeshjen e parë në Krujë. Ai na bën shumë punë. Duke parë Taipin dhe Toskic, që u dëmtua, kemi skuadër me kualitet dhe të rinj. Shpresoj të zgjidhim edhe punën e nënshtetësisë për 2 shqiptarët që janë në fushë. Kemi shumë të huaj, 4 na lejohef. I japin shumë cilësi skuadrës. Pas 4 humbjeve në fazë e parë, mendova se skuadra do e linte pas. U stërvitëm mirë në fazën përgatitore, bëmë miqësore të mira, por u dëmtuan disa lojtarë dhe ndëshja me Partizanin nuk na gjeti të plotë. Prurjet e reja dhe rikthimet nga dëmtimet do na kthejnë në rrugën e duhur."

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- U shkrua nga Zweig.
- Fillojnë aksionin.
- Janë për t'u krentuar.
- Sejdi i tarinerëve.
- Ai i Don Kishotit ishte Sanço Pança.
- Ekstre në tunel.
- I ka tek vrapit.
- Fillojnë andej.
- Nuk tregohet nga i pasigurti.
- Luftojnë me pagesë.
- Inicialet e Gere aktor.
- Sirena që i dha emrin Napoli.
- Gjysmë feje.
- E ka simbolin Co një i tillë.
- Inicialet e Kazan, regjisor.
- Turner aktore.
- Në radhë të parë.
- As unë as ti.
- Janë galeri në rrugë.
- Gibson aktor.

- Ritet pa zë.
- Eshtë edhe ajo e futbollit.
- Një studio... skulptori.
- Janë fushat pa fund në veri të Orinos.
- Fund shkurti.
- Fillojnë ideologjinë.
- Eshtë materia e turrit.
- Një është atleti
- Eshtë ajo që i ka lënë pas të gjithë.

VERTIKAL

- Eshtë edhe ajo epizootike.
- Një është edhe Korabi.
- I këni në dorë.
- Eshtë mbulesë mbi... hambar.
- Kufijtë e kujtesës.
- Janë tek në faqe.
- Kështu përfundon Loreley.
- Një vend nisjeje.
- Në këtë moment.
- Në krye të artistëve.
- Robbins aktor.
- Ai i Hekurt ishte Bismarck.
- Qërohen me... llogari.
- U shkrua nga Kundera.
- Eshtë dhuna me fjalë.
- Yoko e John Lennon.
- Një vepër... taumaturgu.
- Ente Ekonomike Autonome.
- Një mund të jetë cirku.
- Janë indigjenë neozelandezë.
- Eshtë edhe ajo gjeografike.
- Inicialet e Klee piktor.
- Ishin formacionet e famshme maqedonase.
- Eshtë e zakonshme për pushime
- Emil piktor.
- Një planet i Kuq.
- Një garë në hipodrom.
- Me të nxjerrin një liter.
- Qorre pa qe.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Eshtë trofe sportiv.
- U hahen... të martuarve.
- Kufizojnë një truk.
- Kërcimi i Zorba Grekut.
- Mund të jenë kohore.
- Kardashian, aktore dhe modele.
- Janë përmasa.
- Eshtë pjesë e gjuhës.
- Nafta e Shell.
- Një i dhjetë në vit.
- Letra pa zë.
- Janë qederet, dëmet.
- Ishin kundërshtarë të babilonasve.
- Eshtë llon papagalli.
- Tregon çmimin me... mirësjellje.
- Fillojnë ndeshjet.
- Të parat në stadium.

VERTIKAL


- Në krye të kryesisë.
- Eshtë shfaqje e parë.
- Ross këngëtare.
- Kërkojnë talent të tilla.
- Të parat në stadium.
- Një pjesë e makinacioneve.
- Vrau Hektorin.
- Roth aktor
- Qe piktor i famshëm italian.
- Janë vjedhës.
- Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë
- Një ciklist në velodrom.
- Eshtë e ardhur nga firma piramidale.
- Pak diktaturë.
- Një mund të jetë me... ku-ku.
- Nota e diapazonit.
- Masin lëngje të tilla.
- Janë forma.
- I vidhet ustait.
- Eshtë pjesë telefimi.
- Pikas pa ekstreme.
- Eshtë ëmbëlsirë me qiri.
- Umberto poet italian.
- Dy asa.
- Kollet por jo kot.
- Radiotelevizioni i Kosovës.
- Inicialet e Delon.
- Fillojnë afërsisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

7		5	8					1
	3				6			4
					5			
		2					8	9
	4		3	8	9	6		
	6			2	4			7
9							7	2
8			6			9		5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	1	4	3	9	2	7	8	5
2	7	5	4	8	6	9	1	3
3	8	9	7	1	5	4	6	2
9	2	8	5	3	1	6	7	4
1	6	7	2	4	8	3	5	9
4	5	3	6	7	9	8	2	1
5	9	6	8	2	4	1	3	7
7	4	2	1	6	3	5	9	8
8	3	1	9	5	7	2	4	6

Argëtim filozofik

- Sarkazma është streha e fundit e njeriut modest dhe të moralshëm kur privatësia e shpirtit të tij shkelet dhunshëm (Fyodor Dostoyevsky)
- Një betejë është e humbur kur mendon se e ke humbur (Jean-Paul Sartre)
- Jeta është për gatitje e gjatë për diçka që nuk ndodh (W. B. Yeats)
- Fuqinë e mendjes e ke ti, jo ngjarjet jashtë. Kupto këtë, dhe do të gjejsh forcë (Mark Aureli)
- Parë nga larg, çdo gjë është e bukur (Taciti)
- Pasuria është si uji i detit, sa më shumë njeriu i pi aq më i etur bëhet dhe e njëjta është e vërtetë për famën (Arthur Schopenhauer)

KRIPTOSKEME

7	5	4	11	4	1	19	3	13	4	16		
12	1	5	6	3	10	9	3	11	4	13	6	
1	E	13		7	11		4		19	4	7	2
16	S		11	1	5	4	14	15	6	5	3	4
	7	1	5	1	14	18	1	12	3	2	2	
15	1	7	1	13	7	3	19	3	1	13	16	
4	14	1		17	4	14		9	4	7	3	4
9	6			5	5	3	11	3		9	19	
4	5	5		3	1	4		12	3	5		
5	1	4	2		16	1	2	2	1	5	16	
1		18	1	5		4	9	4	14	1	7	3
7	5	4	13	7	3		4	4	10	3	2	

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

B	A	S	T	E	T	P	A	P	A				
U	R	A	T	U	R	H	P	A					
S	A	M	M	M	A	R	A	I	N	I			
T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T			
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E	T		
G	J	I	G	A	N	T	I	I	R	R			
B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	T			
S	A	L	I	R	A	M	A	E					
G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	R			
A	R	E	S	A	O						E	N	E
Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E	T			
I	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S			

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

K	R	E	S	F	D	E	T	I				
M	A	M	A	M	E	P	K	E	L			
T	O	T	R	E	T	O	R	I	K	A	B	O
E	N	O	K	D	O	M	A	T	E	L		
R	M	A	R	T	I	R	E	T	T	O		
I	A	R	A	T	O	N	E	R	R			
A	N	M	O	I	L	A	R	R	O	D		
L	E	A	D	M	A	L	I	A	R			
E	N	T	E	V	E	A	P	L	R			
A	R	M	A	N	I	A	N	D	E			
T	E	R	K	I	T	O	R	I	A	L	E	M
K	L	E	S	A	S	P	A	R	T	A	K	U
K	A	R	R	T	I	E	R	A	A	R	T	
M	E	R	C	E	N	A	R	O				
G	J	A	H	U	N	I	N	J	A	R		
L	E	J	I	T	U	G	S	U	M	O		
F	E	E	T	O	P	A	R					
E	T	A	T	M	S	O	T	E	R	O		
R	M	O	S	A	M	O	T	E	R	O		
O	B	E	R	O	N	M	I	A				
N	I	N	A	M	A	T	H	A	U			
T	A	S	T	I	R	O	I	D	E	T		
I	N	T	E	R	I	M	M	K	E	N		

Thënie të mençura

- Në humbëm, sepse i thamë vetes se humbëm (Leo Tolstoy)
- Injoranca e vërtetë nuk është mungesa e njohurive, por refuzimi për t'i përfutur ato (Karl Popper)
- Nëse përpara iu del një mur, mos u ktheni mbrapa,
- por mendoni se si t'i vini rrotull, ta kapërcëni ose të kaloni nëpër të (Michael Jordan)
- Mos u zemëro me shun: ai thjesht nuk di se si të bjerë lart (Vladimir Nabokov)
- Jo gjithmonë mund të merrni atë që doni, por nëse herë pas here kërkoni, mund merrni çfarë ju duhet (Mick Jagger)

